

**Tillerson
për Ballkanin**
Braktisni
armiqësitë
e vjetra

Fq.3



**BANESA
SOCIALE**

Do ndërtohen
467 banesa sociale,
asnjë në Pollog

Fq.6



**Sharri, Mavrova...
peizazhe që do të
mbrohen**

Fq.8



Koha

www.koha.mk



**Mund të vesh
fanellën e
Mançesterit**

Fq.22

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3233 · e enjte 30 nëntor 2017

6°C | +11°C

15 DEN

EDITORIAL

**“Evropa zdaj”,
ose Evropa sot**



Slovenia në fund ë viteve 90-të
proklamonte parullën
“Evropa zdaj”, ose në shqip “Evro-
pa sot”. 15 vite kaluan deri në vitin
2004, kur shteti alpin iu ba-
shkëngjit Bashkimit Evropian.
Një slogan i tillë, në mënyrë legji-
tim mund të shfrytëzohet edhe
në shumicën e shteteve të tranzi-
cionit, që pretendojnë të anëtarë-
sohen në Bashkimin Evropian.

Fq.2

NË FOKUS

**Rroftë
Flamuri!
Rroftë
Shqipërija!**

Fq.16

GLOBI

**Ndihmoi
refugjatët,
sulmohet me
thikë krye-
bashkiaku**

Fq.15



NË PRITJETË HEQJES SË IMUNITETIT TË DEPUTETËV TË VMRO-së

27 PRILLI DO TË ZBARDHET DERI NË FUND

Gjashtë deputetëve të VMRO-së Kërste Mukovski, Sasho Vasilevski, Johan Tarçullovski, Lupço Dimovski, Zhaklina Peshevska dhe Luben Arnaudov me kërkesë të Gjykatës penale I në Shkup, Parlamenti duhet të vendosë për heqjen e imuniteti të deputetit. Të mërkurën pasdite komisioni për çështje të rregullores mandatit dhe imunitetit, është dashur të vendosë për këtë çështje. Shumicën në këtë komision e ka LSDM dhe BDI.

Fq.4



**libri i
artë**
2017/18

**KOPJE
FALAS**

me gazetën Koha
më 2 Dhjetor
(e shtunë)



www.zk.mk
Android app
iPhone app

EDITORIAL

EVROPA ZDAJ,
OSE EVROPA SOT

Fisnik PASHOLLI

Slllovenia në fund ë viteve 90-të proklamonte parullën "Evropa zdaj!", ose në shqip "Evropa sot". 15 vite kaluan deri në vitin 2004, kur shteti alpin iu bashkëngjit Bashkimit Evropian. Një slogan i tillë, në mënyrë legjitim mund të shfrytëzohet edhe në shumicën e shteteve të tranzicionit, që pretendojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian.

Në Maqedoninë e sotme, parulla Evropa sot, pasqyron edhe dëshirën dhe vullnetin e shumicës së popullatës, që përmes integritit euroatlantik në BE dhe NATO, të rregullojë shtetin konform standardeve më të larta evropiane. Thënë ndryshe, qytetarët presin që rruga evropiane t'u sjellë jo vetëm rritjen e pagave, por edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, si arsimit, shëndetësia, administrata publike e kështu me radhë.

Evropa sot në Maqedoni me një shkallë të lartë të varfërisë dhe papunësisë, nënkupton edhe ndreqjen e disa problemeve që nuk kërkojnë shumë para, por më shumë organizim, vullnet të mirë dhe planifikim nga nivelet më të ulëta deri te ato më të larta.

Evropa sot në Maqedoni nënkupton pastërtinë më të madhe publike, uljen në minimum të deponive të egra, ndërtimin e fabrikave për përpunimin e mbeturinave me partneritet privat-publik, që do të prodhojnë energji dhe do të zbusin dukshëm problemin me hedhjen e mbeturinave, kontroll më të rreptë për miliona e miliona litra, por dhe kilogramë mbeturina që hidhen anekand vendit

Evropa sot në Maqedoni nënkupton edhe ndërtimin e rrugës prej Tetovë deri në Kodrën e Diellit për të mbështetur turizmin malor në Malin Sharr, zgjerimin e rrugës Mavrovë-Dibër që të vijë më shumë turistë në Banjat e Dibrës apo më shumë peshkatarë të vijë për peshkim në Liqenin e Dibrës, ndërtimin e Aeroportit Kargo në Shtip, që do të mundësojë që perimet e freskëta të udhëtojnë drejt Evropës, duke u shitur me çmime të volitshme.....

Evropa sot në Maqedoni nënkupton që nesër kur të fillojmë negociatat me BE-në, një kujdes të veçantë t'i kushtojmë mbrojtjes së interesave të bujqve, që nesër të mos i kapërdijë tregu evropian, siç u ndodh prodhuesit e qumështit në Kroaci.

Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, Evropa sot në Maqedoni nënkupton edhe pagat më të larta për arsimin dhe shëndetësinë, si bazament i zhvillimit dhe përkujdesjes së një shoqërie, si dhe nivelizimin e pagave në administratë, ku ai që ka më shumë ngarkesë dhe obligime do të paguhej më shumë dhe anasjelltas.

MIRËSEVJEN BULLDOZHER

"I urojmë pastrim të mbarë në Maqedoni, ambasadorit të ri amerikan, Hojt Ji. Hiç më shumë e hiç më pak se që bëri kur ishte ambasador në Kroaci. Mirësevjen Bulldozer!", shkruan aktivistja Anita Latifi në Facebook.



KUR HARXHOHEN IDEALET

"Sot kur festojmë Ditën e Flamurit, sot kur shqiptaria është stolitur me ngjyrat Kuq e Zi, duhet të ndjehemi mburrshëm e krenarë, por edhe të kthejmë shikimin nga më e vlefshmjat që kemi rinia! Dhe të shohim se atë rini e stolisë një patriotizëm madhështorë, patriotizëm që ka vlerën e palcës së boshtit kurrizorë të shqiptarisë, por të cilës rini, thuajse ia harxhuam idealet e pastra duke e lënë në duart e manipuluesve të ndryshëm dhe politikanëve të papërgjegjshëm, me çka, atë rini e prumë në situatë t'i braktisë trojet e të parëve dhe t'i ngjajë kalorësit që shkon deri atje ku e çon kali pa frerë! Me çka pra edhe u bëmë popull që ka më shumë flamujbartës Kuq e Zi jashtë, se sa në "Shqipëritë" tona, gjë që nuk është për t'u mburrur, por që tregon se sa i përket rinisë, tokat shqiptarë kanë filluar t'i ngjajnë kopshtit pa rojtarë!", shkruan shkrimtari Kim Mehmeti në FB.




ALBINIZMI NUK MPOSHTET

"As vete nuk e dinë ata që duhet të shkojnë, se sa të mjerë janë kur i burgosin ata që duhet të vijë. Skena të këtitilla do të shohim derisa në pushtet do të jenë profiterët e luftës, si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, të cilëve po u numërohen ditët", shkruan Shpëtim Pollozhani në Facebook.



MAKAR NJË DITË NË VIT, ISHESHQIPTAR

"29 Nëntor! Fytyrat e djeshme mburramane, sot u gdhinë të ngrysura në zhgënjim të thellë, ngashërimi i së cilës është i pashërueshëm, sepse nuk ka mbetur asnjë shpatull që mund ta qullosojmë nga të qarët. Festat janë ngashënjim për njeriun, por tek një ditë pas festës e kupton se s'ka mbetur asgjë për të festuar. Njerëz që shfryjnë mllëfin mbi asgjësinë, s'dinë kënd e shanë e kënd e lavdërojnë, por një zemër e brejtur nga hipokrizia veç shfajtime bubullon, sepse ajo zemër ka një faj. Faj ky që e bën veten të ik nga ty. Sa herë që e takon veten në qorrsoke, e urren; e mëshiron; dhe kjo të përvëlton. Kur takohesh me veten, s'din a ta përqafosh a po ta pështysh në fytyrë. Politikanë me flamuj kuq e zi, fytyra me vetulla të ngrysura e mimikri nga botox-i, buzëqeshje plastike të shtirura e të shpifura. Një nur i rrejshëm mbi fytyrat e tyre. Me siguri nga të shkrepurat e aparatit. T'Vërtetën për t'a kërkuar, për ta rrok e për ta ndërë atë, duhesh të stërvitesh fort. Si duket e Vërteta ka hequr dorë moti nga ne. Skllëvër të injorancës dhe njerëz që krenohen me mposhtjen e tyre. Dje festove se ishe shqiptar, festove për një çast sa për t'i ikur brengave të përditshmërisë. Dje, makar një ditë në vit, ishe shqiptar. E çfarë je sot atëherë? A je njeri më i mirë se ai çfarë ishe dje?", shkruan gazetari Latif Mustafa në profilin e tij në FB.



MEDIACitate

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker tha në intervistë me DW se është "i tronditur" për informacionet që i vijnë nga Afrika. Juncker thotë se Evropa nuk duhet ta mbyllë gojën përballë "problemeve të pabesueshme, të cilat vijnë nga një shekull tjetër. Afrika e njeh mirë problemin e skllavërisë". Juncker foli për një "dramë të përditshme për shumë njerëz - fëmijë, gra dhe burra - në Libi". Juncker tha se fakti që në Libi pas përmirësimit të kontrollit të kufijve me Evropën është rritur numri i migrantëve, që nuk mund të vijnë në Evropë "nuk është shkak i mjaftueshëm, për të plagosur njerëz, për të vrrarë dhe për të vjedhur ata që ndodhen në kampe, të cilat u ngjajnë burgjeve dhe jo kampeve të refugjatëve".

(DW, 29 nëntor)

Departamenti amerikan i shtetit ka thënë se ligji i ri, i cili ia mundëson Ministrisë së drejtësisë së Rusisë, që t'i kategorizojë mediat e jashtme si "agjentë të jashtëm", paraqet kërcënim për lirinë e mediave dhe ka kërkuar nga Moskë që këtë masë të mos e përdorë për ta ashpërsuar kontrollin ndaj mediave. "Liria e fjalës, përfshirë të shprehurit dhe mediat, të cilat qeveria mund të gjejë se janë të papërshtatshme, është e drejtë universale e njeriut e obliguar, për të cilën Rusia ka shprehur përkushtim për ta mbajtur", ka thënë mbremë vonë, zëdhënësjë e Departamentit amerikan të shtetit, Heather Nauert. "Zgjerimi i Ligjit për Agjentët e Jashtëm, me përfshirjen e mediave, e hapë derën për kërkesa të vështira, të cilat e ngushtojnë më tutje lirinë e të shprehurit dhe pavarësinë editoriale në Rusi", ka thënë Nauert.

(Radio Evropa e Lirë, 29 nëntor)

Presidenti Ilir Meta dhe Kryeministri Edi Rama kanë zhvilluar paraditen e kësaj të mërkure homazhe në Varrezat e Dëshmorëve me rastin e 73-vjetorit të Çlirimit. Ata vendosën kurora me lule pranë Monumentit "Nënë Shqipëri", ndërsa të pranishëm ishin edhe Kryetari i Parlamentit, Gramoz Ruci, Kryetari i Bashkisë, Erion Veliaj dhe Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të veteranëve të LANÇ. Ndërkohë, Partia Demokratike vazhdon të festojë datën 28 Nëntor si ditën e Çlirimit.

(Top Channel, 29 nëntor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...


Bjeshkët e Namuna të Kosovës

Bjeshkët e Namuna të Kosovës janë zona malore më e madhe dhe më e lartë e Kosovës, në pjesën perëndimore të saj, kufi me Shqipërinë dhe Malin e Zi, vazhdim i drejtpërdrejtë orografik i Bjeshkëve të Namuna që shtrihen brenda territorit të Shqipërisë. Rrjedhja e sipërme e Bistricës së Pejës i ndan Bjeshkët e Namuna të Kosovës në pjesën jugore dhe veriore. Në pjesën jugore gjenden majat më të

larta, si maja e Ropës, Marjashi, Gjeravica, maja më e lartë e Kosovës (2656 m). Kanë gjithashtu relief të ashpër, të thepisur, me kreshta të ngushta e forma të shumta. Pjesën veriore të Bjeshkëve të Namuna të Kosovës e përbëjnë malet Hajilla, Zhlebi, Mokra etj. Bjeshkët e Namuna kanë pasuri të mëdha ujore dhe janë një nga zonat më të pasura të Ballkanit me bimësi.



TILLERSON THIRRJE BALLKANIT



BRAKTISNI ARMIQËSITË E VJETRA

“Vendeve ballkanike ne u themi braktisini armiçësitë e vjetra, në mënyrë që paqja të bëhet e përhershme. Ju keni shansin të drejtoni një kurs të ri të historisë. Diferencat etnike midis vendeve nuk duhet të shndërrohen më në fronte konfliktesh”, tha Tillerson

Washington, 29 nëntor - Sekretari amerikan i shtetit, Rex Tillerson u përpoq të sigurojë edhe një herë Evropën se Shtetet e Bashkuara mbeten plotësisht të përkushtuara ndaj sigurisë në kontinentin e vjetër, veçanërisht në sprapsjen e kërcënimeve që vijnë nga Rusia. Tillerson, i cili javën e ardhshme do të vizitojë disa kryeqytete evropiane, tha se SHBA do të ishte e para që do t'i përgjigjej çdo sulmi ndaj një aleati evropian, sipas klauzolës 5 të NATO-s që parashikon mbrojtjen e ndërsjellët. Komente të bëra gjatë një fjalimi në Qendrën Wilson në Uashington, synonin të shuanin shqetësimet se administrata “Trump” po tërhiqet nga aleanca me kërkesat që vendet anëtare evropiane të shpenzojnë më shumë për mbrojtjen. Edhe

pse kujtoi se vendet evropiane duhet të marrin më shumë përgjegjësi për sfidat e tyre të sigurisë, ai pranoi se shumë vende i kanë rritur shpenzimet. Mes shteteve që kanë përmbyshur angazhimin financiar përmendi edhe Shqipërinë. Kreu i diplomacisë amerikane ju drejtua në veçanti shteteve të Ballkanit Perëndimor.

“Vendeve ballkanike ne u themi braktisini armiçësitë e vjetra, në mënyrë që paqja të bëhet e përhershme. Ju keni shansin të drejtoni një kurs të ri të historisë. Diferencat etnike midis vendeve nuk duhet të shndërrohen më në fronte konfliktesh. Shtetet e Bashkuara dhe bota dëshirojnë të shohin një brez të ri serbësh, kroatësh, shqiptarësh, bo-

shnjakësh, kosovarësh dhe të tjerë, që të falin atë që ka ndodhur në të shkuarën, edhe nëse nuk mund ta harrojnë atë kurrë”, tha Tillerson. Tillerson përdori një gjuhë të ashpër ndaj Moskës, duke kritikuar veçanërisht ndërhyrjet e saj ushtarake në Gjeorgji dhe Ukrainë si dhe përzjerjen në zgjedhjet dhe politikat evropiane.

HOJT JI, AMBASADOR I RI I SHBA-VE NË MAQEDONI

Hojt Ji do të zëvendësojë ambasadorin aktual Xhes Bejli, i cili ishte emëruar në dhjetor të vitit 2014. Për ndryshe, Ji është diplomat me karrierë dhe për momentin po kryen funksionin e zëvendës asistentit të Sekretarit për Evropë dhe çështje evropiane në administratën amerikane në Uashington. Ai është përgjegjës për marrëdhëniet mes SHBA-ve dhe vendeve të Evropës Qendrore dhe



Juglindore. Para se të emërohet në këtë pozitë, Ji paraprakisht ka punuar si zëvendës shëf i misionit të Ambasadës amerikane në Zagreb të Kroacisë gjatë periudhës 2010 deri në vitin 2013. Gjatë mandatit të tij në Kroaci deri te epilogu i rastit gjyqësor kundër ish kryeministrit kroat, Ivo Sanader, i cili u dënua me katër vjet e gjysmë burg për pranim të ryshfetit.

Shilegov kryetar i BNJVL-së, bojkoton VMRO



Shkup, 29 nëntor - Kryetar i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov është zgjedhur sot kryetar i Këshillit administrativ të Bashkësisë së njësiteve të vetëqeverisjes lokale (BNJVL), ndërsa si zëvendës të tij janë zgjedhur kryetari i Çairit, Visar

Ganiu dhe kryetari i Kavadarit, Mitko Jançev në mungesë të tij. Në seancën e djeshme konstitutive të Asamblesë së përgjithshme janë zgjedhur edhe të gjitha trupat e BNJVL-së. Në seancën nuk morën pjesë kryetarët nga radhët e

VMRO-DPMNE-së opozitare. Shilegov pas zgjedhjes për gazetarët theksoi se këtë funksion e përjeton si një përgjegjësi më tepër, ndërsa prioritet do të jetë vazhdimi i procesit të decentralizimit, që është, siç tha edhe angazhim i Qe-

verisë, si dhe përmirësim i financimit të komunave me qëllim që ata të marrin pavarësi sa më të madhe ekonomike dhe financiare. Ai paralajmëroi se si kryetar i BNJVL-së aktivitetet e tij do t'i orientojë edhe drejt lobimit si në Maqedoni, ashtu edhe para partnerëve të huaj me qëllim që ta përmirësojnë punën e Bashkësisë. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve, Shilegov tha se politika e diskriminimit ndaj njësiteve të pushtetit lokal veç më ndërpritet. Edhe Visar Ganiu, kryetar i Çairit dhe nënkryetar i BNJVL-së, konfirmoi se koncepti i bashkësisë do të jetë i barabartë për të gjitha komunat që të kenë trajtim të njëjtë dhe të gjitha vendimet që do të merren në mënyrë të barabartë të vlejshme për të gjitha komunat.

BE e gatshme për anëtarësimin e Ballkanit në bllok

Bruksel, 29 nëntor - Bashkimi Evropian është gjithnjë e më i gatshëm për të marrë në konsideratë anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në bllok, tha komisionari për zgjerim i BE-së, Johannes Hahn. Sipas tij, anëtarësimi i tyre në BE do të siguronte paqe në rajon, ndërsa do të pasuronte edhe vetë BE-në. “Ka më shumë gatishmëri brenda shteteve anëtare për të adresuar zgjerimin”, tha Hahn për të përditshmen austriake, Wiener Zeitung, transmeton Reuters. Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia janë zyrtarisht kandidatë për anëtarësim në BE, ndërsa Kosova dhe Bosnja po kërkojnë të njëjtin status. BE-ja e sheh rajonin të rëndësishëm për çështjet si kontrollimi i migrimit dhe luftimi i kërcënimeve të sigurisë. “Vendet anëtare e kanë kuptuar se paqja mund të arrihet në Ballkan dhe se perspektiva e anëtarësimit në BE është jetike për të”, tha Hahn.

Pendarovski, koordinatori i ri nacional për NATO-n

Shkup, 29 nëntor - Stevo Pendarovski është emëruar koordinatori nacional për përgatitje të Maqedonisë për anëtarësim në NATO, informoi zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski. Vendimi për emërimin e deputetit të LSDM-së dhe ish-kandidat presidencial, Pendarovski për koordinatori nacional të NATO-s është marrë në seancën e djeshme qeveritare. Pendarovski do ta ndërmarrë funksionin pasi që vendimi do të shpallet në Gazetën zyrtare. Deri atëherë mbetet deputet në Kuvend, ku është edhe zëvendës-anëtar i Komisionit parlamentar për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe të Agjencisë për zbulim. Maqedonia kishte koordinatori nacional për NATO-n në periudhën nga vitin 2006 deri në vitin 2009, kur në atë funksion ishte emëruar ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov. Funksioni mbeti i zbrazët dhe ishte në pezullim pas mospjesëmarrjes së Maqedonisë që të marrë pjesë për anëtarësim në samitin në Bukuresht në vitin 2008.

NË PRITJE TË HEQJES SË IMUNITETIT TË DEPUTETËVE TË VMRO-së



PËR QEVERINË,

27 PRILLI TË ZBARDHET DERI NË FUND

Gjashtë deputetëve të VMRO-së Kërste Mukovski, Sasho Vasilevski, Johan Tarçullovski, Lupço Dimovski, Zhaklina Peshevska dhe Luben Arnaudov me kërkesë të Gjykatës penale I në Shkup, Parlamenti duhet të vendosë për heqjen e imuniteti të deputetit. Të mërkurën pasdite komisioni për çështje të rregullores mandatit dhe imunitetit, është dashur të vendosë për këtë çështje. Shumicën në këtë komision e ka LSDM dhe BDI.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 29 nëntor - Pas arrestimeve të 30 pjesëmarrësve në ngjarjet e dhunshme të 17 prillit, mes tyre dhe gjashtë deputet të VMRO-së, nga Qeveria e Maqedonisë kanë reaguar të mërkurën, duke vlerësuar se institucionet shtetërore duhet ta zbardhin rastin në fjalë, me qëllim që asnjëherë të mos përsëriten më ngjarje të tilla në Parlament. "Vlerësojmë se institucionet kanë për detyrë ta zbardhin rastin për shkak të nevojës për drejtësi dhe sundimin e së drejtës në Republikën e Maqedonisë dhe më asnjëherë mos të përsëritet një gjë e tillë", tha zëdhënësi i Qeverisë, Boshnjakovski, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve.

Në lidhje me takimin të presidenti Ivanov, që patën kryeministri Zoran Zaev dhe kryetari i VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski, zëdhënësi i Qeverisë theksoi se bëhet fjalë për një dukuri të rregullt në suaza të disa proceseve demokratike. "Ftesa erdhi nga presidenti Ivanov dhe kryeministri Zaev ishte i pranishëm në atë takim. Aty u diskutuan për të gjitha çështjet e hapura dhe ngjarjet që ndodhën këto ditë", tha Boshnjakovski gjatë një takimi me gazetar. Ndërkaq, kryeministri Zoran Zaev, lidhur me arrestimet që bëri prokuroria publike nuk dëshoi të komentojë për veprime të organeve gjyqësore, por tha se pret të respektohet kushtetuta dhe ligjet në fuqi.

"Pres që të respektohen kushtetuta dhe ligjet. Të ketë kujdes për çdo gjë që i respektojnë normat juridike në vendin tonë dhe asgjë më pak ose më shumë", deklaroi Zaev. Ai tregoi se për çfarë kanë biseduar me Presidentin Ivanov, duke thënë mes tjerash se me partitë politike

duhet të ketë dialog, siç tha Zaev për të gjetur zgjidhje politike. "Mbrëmë patëm takim me kryetarin Gorgje Ivanov dhe biseduam për normalizimin e proceseve politike në vend. Qëllimi i takimit ishte normalizimi i proceseve politike në shtet, për atë se çka shkakton reagim te qytetarët, sepse kishte aktivitete të udhëhequra nga Prokuroria Publike dhe nga gjykatat në lidhje me ngjarjet e 27 prillit. Nuk do doja t'i komentoj vendimet gjyqësore ose ngjashëm jam i përkushtuar në aspektin politik dhe për shkak të asaj që jam politikan, besoj se në Maqedoni gjithsesi se duhet të ketë sundim të së drejtës, por njëkohësisht duhet të jemi të kujdesshëm për shkak të perspektivave të shtetit. Maqedonia është e drejtuar kah proceset serioze, na presin reforma serioze dhe besoj se në atë frymë absolutisht përmes bisedave me subjektet politike të gjejmë zgjidhje", tha Zaev. Ai shtoi se te kryetari i shtetit është biseduar edhe për normalizimin e ngjarjeve politike. "Veçanërisht u theksua nevoja e opozitës që të kyçet në proceset të cilat vinë dhe gjithsesi se e shprehin pakënaqësinë e tyre, për shkak të rasteve që kanë implikime të përcaktuara ligjore, të shprehur përmes lëndëve që zhvillohen nga ana e organeve gjyqësore", theksoi Zoran Zaev, duke shtuar se takimet dhe bisedat me presidentin dhe opozitën do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Nga na tjetër, lideri i VMRO-së, Nikolla Gruevski, në një pronon-

cim për media, tha se në takimin me presidentin Gorge Ivanov kanë biseduar për atë që duhet që të qetësohen të dyja palët. Gruevski shtoi se edhe presidentit Ivanov ka bërë me dije qëndrimin e tij, që është kundër këtyre arrestimeve dhe gjithashtu tha se të njëjtën që e ka deklaruar në konferencë, e ka thënë edhe para Ivanovit. Lidhur më zërat se pas arrestimeve të bashkëpunëtorëve të ngushtë të tij, deputetët e VMRO-së mund ta braktisin Parlamentin, Nikolla Gruevski tha se ende nuk ka një vendim partiak.

Ndryshe gjashtë deputetëve të VMRO-së, Kërste Mukovski, Sasho Vasilevski, Johan Tarçullovski, Lupço Dimovski, Zhaklina Peshevska dhe Luben Arnaudov Gjykata penale i në Shkup i kërkoi nga Parlamentit që t'u merret imuniteti. Të mërkurën, Komisioni për çështje të mandateve dhe imunitetit është pritur të mbledhet pas dite, kjo për shkak se kryeparlamentari Talat Xhaferi është dashur të mbërrijë në vend në mesditë pas vizitës zyrtare në Suedi. Sipas asaj që ka thënë kryetari i komisionit, Stefan Bogovovski, se pas kërkesë për të thirrur mbledhje nga kryeparlamentari i duhet më së paku një orë që të njoftohen anëtarët e Komisionit. Sipas Rregullores së Parlamentit, Komisioni sjell vendim me shumicë votash, por vendimin final për marrjen e imunitetit e sjell Parlamenti, që në afat prej 3 deri 8 ditë, duhet ta miratojë ose ta refuzojë raportin e komisionit, gjë për

të cilën nevojiten votat e 61 deputetëve. Mes deputetëve që duhet të vendosin për heqjen e imunitetit, janë dhe dy deputetët e arrestuar Kërste Mukovski dhe Johan Tarçullovski, të cilët duhet të votojnë për veten e tyre. Nga VMRO nuk pati qëndrime nëse do të marrin pjesë në mbledhje në këtë komision, ku shumicën e kana dy partitë, LSDM dhe BDI. Përveç kryetarit që vjen nga radhët e LSDM-së, Stefan Bogovovski, edhe zëvendëskryetari është nga kjo parti, Petar Atanasov, ndërsa anëtar tjerë janë Aleksandër Kiracovski, Sasho Kostov nga LSDM, Miroslav Jovanoviq (partia serbe) Agim Shaqiri nga BDI, Trajko Veljanovski, Johan Tarçullovski, Kërste Mukovski dhe Boris Zmejovski nga VMRO. Për arrestimet e protagonistëve kryesorë të ngjarjeve të 17 prillit, të mërkurën reagan nga Ambasada amerikane në Shkup, e cila bën thirrje për transparencë më të madhe dhe ndjekje të procedurave dhe ndriçim të ngjarjeve të 27 prillit në Kuvendin e Maqedonisë, raporton Meta.mk.

"I ndjekim lajmet për arrestimet. I bëjmë thirrje policisë dhe prokurorisë të vazhdojnë me zgjidhjen e rasteve me transparencë absolute dhe me respektim të proceseve juridike. Edhe pse kryerësit e sulmeve të 27 prillit duhet të përballen me përgjegjësi për veprat e kryera, përsëri të gjithë personat kanë të drejtën e prezumimit të pafajësisë", deklaroi për agjencinë lajmeve "Meta" nga Ambasada e ShBA-së në Maqedoni, duke u përgjigjur në pyetjen gazetareske se si i komentojnë arrestimet e djeshme të 36 personave, në mesin e të cilëve edhe deputetë, për dhunën në Kuvendin e Maqedonisë.



Policia ka bastisur edhe shtëpinë e Trajko Veljanovskit

Sipas burimeve të gazetës Koha nga Prokuroria publike themelore, gjatë aksionit të djeshëm policor për rastin e ngjarjeve të 27 prillit në Kuvendin e Maqedonisë, policia ka bastisur edhe shtëpinë e ish kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë, Trajko Veljanovski, aktualisht deputet i VMRO-DPMNE-së. Nga ajo që ka arritur të kuptojë gazeta Koha, gjatë aksionit policor, atij i është marrë telefoni celular. Ndryshe, duke vepruar sipas propozimit të PTHP-së për përndjekjen e krimin të organizuar dhe korrupsionit për përcaktimin e masës paraburgim, para gjykatësit të procedurës paraprake pranë Gjykatës Themelore Shkup 1 - Shkup gjatë ditës së djeshme janë nxjerrë 24 persona, për të cilët pas deklarimit të tyre lidhur me propozimin e Prokurorisë, janë marrë vendime me të cilat personat M.Ç., O.P., I.D., M.P., O.R., G.A., V.T., D.L., I.C., B.I., J.Ç., I.S. dhe V.M. gjykatësi i procedurës paraprake e pranoi propozimin dhe u caktoi masë paraburgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh. Personave S.M., G.G.J., M.P., E.D.B., B.D., V.J., Gjykata u caktoi masë arresti shtëpiak.

Arrestimet, Ivanovi i bën bashkë Gruevskin dhe Zaevin

Shkup, 29 nëntor - Me ftesë të presidentit të Republikës së Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, mbrëmë në Kabinetin e tij u mbajt një takim ku të pranishëm ishin kryeministri Zoran Zaev dhe lideri i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski. Temë e bisedimeve ishin ngjarjet aktuale. Është biseduar për zgjidhje të mundshme për dalje nga gjendja aktuale e tensionuar në vend e që paraqet shqetësim për qytetarët. Qëllimi i takimit ishte që të nxitet qetësia dhe normalizimi i proceseve politike në Republikën e Maqedonisë.

Shumë profesorë universitar dhe avokatë, gjatë komentimit të aktakuzës për 36 të akuzuar, kanë shtuar se nga përgjegjësia penale nuk duhet të shpëtojnë as prokurorët publike, të cilët pas ngjarjeve të 27 prillit vendosën që këtë rast ta hetojnë si vepër penale, “pjesëmarrje në turmë”

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 29 nëntor - Shtatë muaj pas ngjarjeve të dhunshëm që ndodhën në Parlamentin e Maqedonisë, Gjykata Penale e Shkupit, me propozim paraprak të Prokurorisë për krim të organizuar, 13 persona u ka shqiptuar masën e paraburgimit 30 ditor. Nga ana tjetër, 6 të tjerëve, të arrestuar mëngjesin 28 nëntorit, kjo Gjykata u ka caktuar masën arrest shtëpiak. Tre udhëheqësve të protestave “Për Maqedoninë e bashkuar”, gjykatësja në procedurë paraprake Vesna Dimishkovska, u ka caktuar masën e paraburgimit, respektivisht dy organizatorëve Bogdan Ilievskit (Betmen) dhe tenorit Igor Durllovski, u ka shqiptuar paraburgim 30 ditor për në burgun e Shutkës. Ndërsa, organizatorit të tretë Boris Damovski, gjykata i ka caktuar vetëm arrest shtëpiak. Aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Publike, për ngjarjet e 27 prilli, e përbënë një listë prej 36 të akuzuarve, në mesin e të cilëve mund të shihen profile të ndryshme të të dyshuarve për veprën penale “terrorizëm”. Gjykata Penale e Shkupit, mes tjerash, gjatë ditës së martë, paraburgim 30 ditor i ka caktuar edhe ish drejtorit të Byrosë për Siguri Publike, Mitko Çavkov, nëpunësve të policisë, Munir Pepiq dhe Oliver Radulov, kryetari të Shoqatës “Qoseto”, Goran Angellov dhe disa të akuzuarve tjerë, të cilët kryesisht atë kohë kanë qenë të angazhuar në struktura e policisë dhe atyre për sigurimin e Parlamentit. Aksionit policor të realizuar me 28

DHUNA E USHTRUAR NË PARLAMENT DREJTË ZBARDHJES



ORGANIZATORËT E 27 PRILLIT NË PARABURGIM 30 DITOR

nëntor nuk i kanë shpëtuar edhe një pjesë e deputetëve, gjegjësisht arrest shtëpiak GJPSH-ja të martën i ka caktuar deputetes Zhaklina Peshevska. Në kumtesën për media nga Prokuroria publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, kanë theksuar janë gjithsej 36 persona me akuzë për veprën penale “terrorizëm”. Vendimi për ngritjen e kësaj aktakuzë, nga kjo prokurori kanë thënë se është realizuar pas përfundimit të procedurave para-hetimore dhe atyre hetimore. Kodi Penal i Maqedonisë, për aktakuzën e ngritur nga Prokuroria në fjalë, ka paraparë që dënimet minimale të jene deri në 10 vite heqje lirie. Burime brenda GJPSH-së, thonë se marrja në pyetje është realizuar me 24 të akuzuar, me çka ndaj 12 të akuzuarve të tjerë, organet e rendit janë vënë në kërkim. Meqë në këtë lëndë të iniciuar nga Prokuroria si të akuzuar ngarkohen edhe gjashtë deputetë, Komisioni për emërimin dhe verifikimin e mandatave, në periudhën në vazhdim, duhet të konstatojë heqjen e imuniteti të deputetëve Johan

Tarçullovski, Kërste Mukovski, Zhaklina Peshevska, Luben Arnaudov, Sasho Vasilevski dhe Lupço Dimovski. Me rregulloren e Parlamentit, imuniteti i deputetëve vlen vetëm nëse vepra penale e kryer nga ndonjë deputet nuk i kalon dënimin prej pesë viteve heqje lirie. Në këtë rast, vepra penale “terrorizëm”, parasheh që dënimi më i ulët nuk mund të jetë nën dhjetë vite burg. Ekspertët e lëmit penale dhe ato të sigurisë, duke komentuar këtë aksion policor, kanë thënë se Gjykata, pas fillimit të procesit gjyqësor, duhet të vërtetojë përgjegjësinë individuale të çdo të akuzuarit. Kësisoj, organizatorët e protestave duhet të përgjigjen për turmën e cila është futur në Parlament dhe e cila në masë të madhe e rrezikoi jetën e deputetëve, në radhë të parë të deputetit Zijadin Sela dhe deputetëve tjerë. Pastaj, ish krerët e lartë të policisë duhet sqarojnë se pse nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për shpërndarje në turmës dhe lejimin e tyre që në mënyrë shumë të thjeshtë të futen në institucionin më të

lartë të shtetit, Parlamentin. Njëkohësisht, nëse paraprakisht ndonjëri prej të akuzuarve nuk vendos që ta pranojë fajin, Prokuroria duhet të zbulojë se kush kanë qenë urdhëruesit e këtij skenari të përgjakshëm, me tendencë për të likuiduar. Shumë profesorë universitar dhe avokatë, gjatë komentimit të aktakuzës për 36 të akuzuar, kanë shtuar se nga përgjegjësia penale nuk duhet të shpëtojnë as prokurorët publike, të cilët pas ngjarjeve të 27 prillit, vendosën që këtë rast ta hetojnë si vepër penale “pjesëmarrje në turmë”.

Ndryshe, gjatë muajve të kaluar Ministria e Punëve të Brendshme, realizoi një sërë aksionesh policore, të cilat lidhen me ngjarjet e 27 prillit, respektivisht këto bastisje të kryera nga policia e shtetit, enkas kishin të bëjnë me sulmuesit e deputeti Zijadin Sela. Numri i të akuzuarve për sulmin ndaj Zijadin Selës shkon deri në 12 persona, për të cilët Gjykata Penale e Shkupit, ende nuk ka caktuar datë se kur do të fillon procesi gjyqësor kundër tyre.

BASHKËVEPRUESI TIA KTHEJNË SHPINËN NIKOLLA GRUEVSKIT

Një nga një “shuplakat” zberthehen

Shkup, 29 nëntor - Të akuzuarit për rastin “Shuplakat”, një nga një janë duke e pranuar fajin dhe akuzat e ngritura nga Prokuroria Speciale Publike. Në seancën gjyqësore, e cila u zhvillua ditën e mërkurë, i akuzuari i pestë për sulmin në Komunën Qendër, në qershor të vitit 2013, Jordan Ristevska, kërkoi falje nga Trupi gjyqësor, me çka tha se ndihet fajtor për veprimet, të cilat i ka kryer dhe se është penduar për ato akte. Ky vendim i të akuzuarit Ristevski, palën mbrojtëse të kryesuar nga avokati Boro Tasevski, siç duket e befasoi, me çka ky i fundit i tha gjykatës Tatjana Mihajlovska, se tutje nuk do ta përfaqëson të akuzuarin. Prokuroria special, Fatime Fetaj, dukshëm e befasuar, kërkoi nga Gjykata, që lënda për të akuzuarin Ristevski, të ndahet dhe ndaj tij të zhvillohet proces i posaçëm gjyqësor. Pranimi i fajit edhe nga një i akuzuar në procesin gjyqësor për dhunën në Komunën Qendër, rezultoi pasi që javën e kaluar, në një procedurë të ngjashëm, ish kryetari i degës së VMRO-DPMNE-së në Qendër, Tomislav L Lazarov, tha se ndihet fajtor për shkeljet e bëra në qershor të vitit 2013. Pendimi për veprën penale, nga PSP-ja e vlerësuan si rrethanë lehtësuese, respektivisht javën e kaluar Gjykata Penale e Shkupit, ish këshilltarit Tomislav L Lazarov, i shqiptoi dënimin me kushte prej gjashtë muaj burg, nëse brenda dy viteve të ardhshme nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Ndryshe, të mërkurën, procedimi i rastit kundër ish kryeministrit Nikolla Gruevski dhe ish ministrit të Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski, u prolongua për datë 7 dhjetor, me arsyetim se avokati i një pjese të të akuzuarve, Dončo Nakov, me njoftim paraprak e kishte paralajmëruar mungesën e tij. Përfaqësuesit e PSP-së, me këtë rast thanë se kërkesa e të akuzuarve që kjo seancë të prolongohet është e mbështetur në dispozita e Ligjit për procedurë penale. Mirëpo, prokurorja speciale Fatime Fetaj, tha se kjo është hera e fundit që ata të pajtohen për anulimin e seancave, për shkak se, siç tha ajo, të gjitha seancat që prite të mbahet në të ardhmen pala mbrojtëse i ka të ditur. Shpallja e vendimit për të akuzuarin Jordan Ristevski, Gjykata ka thënë se do kumtoj gjatë ditës se enjte. (O.XH.)

GATI LIGJI I RI PËR AMNISTI

Nuk amnistohen të akuzuarit e 27 prillit

Shkup, 29 nëntor - Qeveria e Maqedonisë, në seancën e fundit shqyrtoi dhe miratoi Ligjin për amnisti si tekst propozim i dalë pas debatit publik. Lidhur me këtë, Qeveria angazhoi Ministrinë e Drejtësisë që të përpilojë Projekt ligjin dhe i njëjti t'i dorëzohet Parlamentit të Maqedonisë për miratim. Sipas zëdhënësit të Qeverisë, Mile Boshnjakovski, Qeveria vetëm se ka miratuar Propozim ligjin me të gjitha vërejtjet dhe propozimet e dala nga debati paraprak publik dhe hapi ardhshëm është i Ministrisë së Drejtësisë të përpilojë tekstin final të Ligjit për

amnisti dhe të njëjtin ta lëshojë në procedurë të rregullt në Parlament. Pasi ligji të futet në Parlament, sërish do të ketë debat në komisionet parlamentare.

“Ligji do të silltet sipas procedurës së rregullt në Parlament dhe dispozitat e këtij Propozim ligji parashohin që amnistia do të vlejë për të gjitha ata persona, veprat e të cilëve janë kryer deri më 20 shtator të vitit 2017 dhe të njëjtit janë duke vuajtur dënimin”, tha Boshnjakovski në takim me përfaqësuesit e mediave. Kështu, siç parasheh Propozim ligji për amnisti, Boshnjakovski theksoi se

nuk mund të amnistohen ata persona që vuajnë dënim më burg të përjetshëm si dhe të burgosurit që kanë kryer vepër penale vrasje me paramendim, të burgosurit që kanë kryer veprën penale pengim të procesit zgjedhor si dhe persona që kanë kryer vepër penale kundër shtetit dhe rendit publik. “Me këtë ligj saktë përcaktohet se cilët persona do të mund të amnistohen. Pra, të gjithë ata persona të cilët janë dënuar për vepër penale, të cilët deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji kanë filluar me vuajtjen e dënimit, do t'i përfshijë ky ligj”, tha Boshnjakov-

ski. Në pyetjen se më këtë ligj a do të mund të amnistohen 36 persona, të cilët akuzohen si organizatorë apo pjesëmarrës në ngjarjen 27 prillit, Boshnjakovski tha se Propozim ligji është i qartë: do të mund të amnistohet të gjithë ata persona që tani më vuajnë dënimin për vepra të penale të kryera deri më 20 shtator të këtij viti. Statistikat për momentin tregojnë se me këtë ligj, të drejtë për amnisti kanë rreth 670 persona që janë të dënuar me burg prej 6 muajve dhe rreth 3097 persona do t'ju zvogëlohet dënimi për 30 për qind. (Z.V)

1 DHJETORI - DITA NDËRKOMBËTARE E SIDËS

PËR TRE DEKADA 338 TË PREKUR ME VIRUSIN HIV

Në periudhën prej vitit 1987 deri në vitin 2017, nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara me infeksionin HIV është 338, derisa numri i personave të vdekur që si shkak kanë pasur lidhshmërinë me SIDË-n, është 83

Koha

Aida XHONI

Shkup, 29 nëntor - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), alarmon për epidemi të HIV-it në Evropë. Në një raport të përbashkët të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollimin e Sëmundjeve, thuhet se 160,000 njerëz janë prekur me virusin që shkakton AIDS-in, vitin e kaluar. Të diagnostifikuarit janë regjistruar në 53 vende dhe rreth 80 për qind e tyre ndodhen në Evropën lindore.

Sa i përket Maqedonisë, vitin e kaluar janë zbuluar 33 raste të reja (që të gjithë meshkuj), ndërsa dy nga ato kanë vdekur. Statistikat e Institutit për Shëndet Publik, thonë se në gjashtë mujin e parë të këtij viti në Maqedoni janë regjistruar edhe 22 raste të reja, bëhet fjalë për banorë nga Shkupi, Tetova, Gostivari, Prilepi dhe Vallandova. Asociacion për edukim shëndetësor dhe hulumtim - HERA, fton gjithë qytetarët të cilët nuk e dinë gjendjen e tyre të bëjnë HIV test në qendrat më të afërta për testim, i cili është falas, vullnetar dhe i besueshëm, ndërsa rezultatet do t'i marrin për më pak se 30 minuta dhe janë të garantuara.

"Në periudhën prej vitit 1987 deri në vitin 2017, nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara me infeksionin HIV është 338, derisa numri i personave të vdekur që si shkak kanë pasur lidhshmërinë me SIDË-n, është 83. Pjesa më e madhe e infektiveve ka ndodhur nëpërmjet marrëdhënieve të pambrojtura seksuale. Në këtë moment, në Shtëpinë e shëndetit publik në Klinikën Universitare për sëmundje infektive dhe gjendje febrile me terapi antiretrovirale mjekohen 190 pacientë", tha për gazetën KOHA, Elizabeta Bozhinowska, koordinatore nga Asociacioni HERA.

Sipas Bozhinovskës, Republika e Maqedonisë obligohet t'i jep fund epidemisë HIV, si problem shëndetësor publik deri në vitin 2030. [Gjithashtu obligohet që me deklaratën politike për HIV dhe Sidë të dhënë në Kuvendin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që deri në vitin 2020 të arrijë qëllimin 90-90-90, përkatësisht 90% nga përqindja e pacientëve që jetojnë me HIV ta dinë statusin e tyre, 90% të vendosen në terapi antiretrovirale dhe 90% nga ata që marrin terapi të kenë kontrollim të suksesshëm të infektimit.

Dita botërore kundër AIDS është një ditë që kujtohet çdo 1 dhjetor që prej vitit 1988, që

“
Nga paraqitja e epidemisë, në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar, me virusin HIV janë infektuar gjithsej 76,1 milionë persona. Që atëherë rreth 35 milionë persona kanë vdekur nga kjo sëmundje

ditën kur ministrat e shëndetësisë nga e gjithë bota, u mbledhën për të diskutuar mbi AIDS-n, kur u fol shumë lidhur me tolerancën, shkëmbimin e hapur të informacionit dhe përvojën në luftën kundër tij. Nga Sida vitin e kaluar, në botë humbën jetën një milion persona, që është dyfish më pak se në viti 2005, ku kjo sëmundje mori jetën e pothuajse dy milionë vetëve, njoftoi KB-ja.

Në vitin 2016, 19,5 milionë persona kanë pasur qasje në mjekim nga gjithsej 36,7 milionë persona që jetojnë me virusin HIV. Nga paraqitja e epidemisë, në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar, me virusin HIV janë infektuar gjithsej 76,1 milionë persona. Që atëherë rreth 35 milionë persona kanë vdekur nga kjo sëmundje.

KRONIKË

Kallëzime penale për sulmuesit me vetura

Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë ka ngritur kallëzim penal, ndaj personit me initiale M.H., 28 vjeçar nga Shkupi dhe A.F., 31 vjeçar nga fshati Zherovjan, për shkak të dyshimeve se kanë kryer vepër penale, "rrezikim të sigurisë së përgjithshme. Sipas policisë, më 7 korrik, rreth orës 12 e 30 minuta në mesnatë, përderisa dy persona të moshës 28 dhe 32 vjeçar, shtetas të Gjermanisë, me veturë me targa të Gjermanisë, kanë qenë duke qarkulluar në rrugën e fshatit Tenovë, në hyrje të fshatit ka qenë i parkuar personi nga Zherovajni, i cili për shkak të llogarive të papastruara, u ka zënë rrugën. Në atë moment ka arritur edhe i denoncuar i dytë me veturën e tij dhe e ka goditur pjesën e pasme të veturës së tyre, ndërsa personi tjetër po ashtu me veturë, i ka goditur në pjesën anësore, por t dy personat kanë arritur që të ikin dhe ta denoncojnë rastin në stacionin e Policor në Zherovjan.

I vjedhin 2 mijë euro me dhunë nga xhepi

Të martën rreth orës 17 e 15 minuta, në Gostivar dy persona të panjohur kanë plaçkitur personin I.D. 44 vjeçar me ç'rast nga xhepi i palltos kanë arritur t'i marrin 120 mijë denarë. Sipas policisë, përderisa I.D ka qenë duke lëvizur ka vërejtur se është duke u ndjekur dhe kur ka arritur para shtëpisë së tij, njëri ia ka mbyllur gojën prej pas kurse një tjetër i ka kërkuar paratë në xhepa. Në momentin kur ia kanë marrë paratë ka dalë gruaja nga oborri dhe ka filluar të bërtasë, ndërsa dy personat janë larguar në drejtim të panjohur. Policia ndërmerr masa për gjetjen e autorëve të kësaj vjedhje.

Zjarr në katër shtëpi në Zllokuqan

Një zjarr ka shpërthyer në pasditen e sotme në lagjen Zllokuqan të Shkupit ku janë përfshirë katër shtëpi. Komandanti i Brigadës zjarrfikëse territoriale e Qytetit të Shkupit, Zvonko Tomeski për MIA-n deklaroi se zjarri është shuar me kohë dhe se në terren është intervenuar me 13 zjarrfikës dhe pesë automjete. "Ekzistonte rrezik nga përhapja e zjarrit, por me kohë u intervenua. Nuk ka persona të lënduar", deklaroi Tomeski. Zjarri shpërtheu në rrugën "Skupi nr.12". Dëmi material në mënyrë shtesë do të konfirmohet. (U.H)

EDHE NJË PROJEKT QË ANASHKALON SHQIPTARËT

Do të ndërtohen 467 banesa sociale, asnjë në Pollog



Shkup, 29 nëntor - Në periudhën e ardhshme është planifikuar ndërtimi i 467 banesave sociale në Shkup, Pehçevë, Sveti Nikollë, Vinicë dhe Probishtip, deklaroi të mërkurën ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski. Në Shkup është parashikuar ndërtimi i 312 banesave sociale, nga 34 në Pehçevë dhe Sveti Nikollë, 39 në Vinicë dhe 48 në Probishtip. Pas takimit me drejtorin e SHA për Ekonomizim me Hapësirë Banesore dhe Afariste Hristian Trajkovski, ministri tha se Qeveria fuqimisht është e përkushtuar në zgjidhjen e çështjes së banimit të kate-

gorive më të ndjeshme të qytetarëve dhe për shkak të kësaj në takimin e ardhshëm do të intensifikohen aktivitetet. Banesat për kategoritë e ndjeshme sociale janë me madhësi prej 35 deri në 45 metra katrorë. "Bëhet fjalë për banesa të vogla të cilat do të mund të shfrytëzohen me çmim prej 15 denarëve për metër katrorë. Në vijim është harmonizimi i aktiviteteve me ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe të Punës dhe Politikës Sociale", deklaroi Trajkovski. Me ministrin e Punës dhe Politikës Sociale, siç tha, po bisedohet që të gjindet zgjidhje si të rregullohet në mënyrë më të thjeshtë pagesa e kompensimit. Veçmë kanë përfunduar ndërtesat me 43 banesa sociale në Koçanë dhe me 10 banesa në Makedonski Brod, ndërsa sipas

Sugareskit, deri në fund të vitit apo në fillim të vitit të ardhshëm do të shpallet thirrje për shpërndarjen e tyre. Në vijim është ndërtimi edhe i dy ndërtesave në Gostivar me 70 banesa dhe në Strumicë me 41 banesa, të cilat pritet të jen gati vitin e ardhshëm. "Procedura gjatë shpërndarjes së banesave do të jetë transparente", tha Sugareski. Aktivitetet e paralajmëruara janë pjesë e projektit me të cilin deri në vitin 2020 duhet të ndërtohen 33 ndërtesa me 1.741 banesa për kategoritë e ndjeshme sociale. Deri më tani janë ndërtuar 16 ndërtesa me 731 banesa. Projekti zbatohet me bankën për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës, me buxhet prej 50.700.000 euro, prej të cilave 50 për qind janë siguruar nga Buxheti i RM-së.

SË SHPEJTI NJË INSTRUMENT I RI MBI PALËT E INTERESIT

KËSHILL KOMBËTAR PËR ARSIMIN E LARTË

Prof.dr. Avzi Mustafa e sheh këtë Këshill edhe në rolin e korrektuesit mes Ministrisë dhe universiteteve në periudhën e përpilimit të ligjeve dhe në fazën e zbatimit të tyre, por edhe të këshilluesit në rastet e paraqitjes së problemeve, kontesteve dhe mosfunksionimit të duhur të gjërave

teggjisë Gjithëpërfshirëse të Arsimit 2018-2025, arsimit i lartë do të ketë një instrument të ri për rregullimin dhe korrigjimin e mangësive që aktualisht janë evidente në sferën e arsimit të lartë.

Për njohësit e çështjeve arsimore, themelimi i një institucioni të këtillë, që në Strategji është emëruar si Këshill Kombëtar i Arsimit të Lartë (KKAL), është tregues i qartë për seriozitetin me të cilin është ndërmarrë aktiviteti rreth ndryshimeve cilësore që pritet të ndodhin në sferën e arsimit në përgjithësi. Prof.dr. Avzi Mustafa, thotë se është koha e fundit që arsimit në përgjithësi, e sidomos ai i nivelit të lartë t'u nënshtrohet reformave rrënjësore, të cilat duhet të rezultojnë me më shumë mekanizma kontrolli dhe ndërmjetësimi mes të gjitha palëve (aktorëve) në sferën e arsimit të lartë. "Si asnjëherë deri më tani, arsimit i nivelit të lartë ka nevojë për ndryshime të mirëfillta", shprehet Mustafa, ndërsa vëren se themelimi i një institucioni si KKAL-ja, do të shërbejë mjaft mirë si mekanizëm për të korrigjuar devijimet dhe mangësitë që mund të pa-

raqiten në punën dhe e veprimtarinë e të gjitha institucioneve që kanë të bëjnë me arsimit të lartë.

"Nga sa është parë në praktikën e deritanishme, reformat janë të domosdoshme në të gjitha hallakat e sistemit arsimor. Bazuar në paralajmërimet dhe propozimet e Strategjisë, duket se ndryshimet do të marrin rrugë të mbarë", shprehet Mustafa, ndërsa nuk fsheh kuriozitetin e shtuar sa u përket propozimeve në sferën e arsimit të lartë. Autor i 30 botimeve shkencore dhe letrare, pedagogu tanimë në pension Mustafa, edhe pse nuk ka qenë i kyçur drejtpërdrejtë në përpilimin e Strategjisë 2018-2025, nuk e ka problem të shprehet pozitivisht për gjërat që duket se cilësore, sikurse e vlerëson në këtë rast propozimin për themelimin e KKAL-së. Por, pavarësisht kësaj, ai thotë se ky Këshilli duhet të jetë para së gjithash i pavarur, që të mund të shërbejë si urë lidhëse mes MASH-it dhe aktorëve të tjerë pjesëmarrës në komplet sistemin e arsimit të lartë. Prof. dr. Mustafa e sheh KKAL-në edhe në rolin e korrektuesit mes MASH-it dhe universiteteve, si në pe-



AVZI MUSTAFA

Nga sa është parë në praktikën e deritanishme, reformat janë të domosdoshme në të gjitha hallakat e sistemit arsimor. Bazuar në paralajmërimet dhe propozimet e Strategjisë, duket se ndryshimet do të marrin rrugë të mbarë

riudhën e përpilimit të ligjeve, ashtu edhe në fazën e zbatimit të tyre, por edhe të këshilluesit në rastet e paraqitjes së problemeve, kontesteve dhe mosfunksionimit të duhur të gjërave. "Me funksionimin e KKAL-së do të eliminohen mangësitë, të cilat janë momentalisht në ligjet e arsimit të lartë, në funksionimi e institucioneve kompetente, rregullimin e ofertës akademike me tregun e punës dhe kështu me radhë", shprehet ai,

Sipas asaj që propozohet në Strategjinë 2018-2025, KKAL-ja nuk do të zëvendësojë punën e Këshillit për Akreditimin dhe Evoluimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe as punën e Konferencës Ndëruniversitare në Maqedoni. Përkundrazi, do të jetë një instrument i ri, i cili do të qëndrojë mbi të gjitha palët e interesit apo aktorët e deritanishëm të arsimit të lartë. Këshillimi i Akreditimit do të jetë gjithashtu në shënjestër të reformave, pasi kërkohet "përmirësimi shtesë i punës së Këshillit të Akreditimit dhe Evoluimit", me qëllim të rritjes së kualitetit të arsimit të lartë. Paralelisht të gjitha reformave në arsimin e lartë, MASH do të duhet të del edhe me një propozim për përpilimin e një Ligji të ri. Ligji aktual, i nxjerr në vitin 2008, është ndryshuar dhe plotësuar plotë 21 herë.

Amvisëritë, ndotëset më të mëdha të ajrit

Shkup, 29 nëntor - Ngrohja e shtëpive është burimi më i madh i ndotjes së ajrit. Këtë e tregon raporti për cilësinë e ajrit të përgatitur nga Grupi interdikasterial i formuar nga 17 institucione shtetërore dhe organizata ekologjike civile. Raporti dje ishte miratuar në seancë qeveritare dhe në periudhën e ardhshme pritet së bashku me rekomandimet dhe masat të prezantohet para opinionit. Një pjesë e masave që rekomandohen që të ulet ndotja janë fillimi i procesit për kthim eventual të qytetarëve të shlyçur nga sistemi për ngrohje qendrore në Qytetin e Shkupit, të bëhen ndryshime ligjore me të cilat çdo investues gjatë marrjes së lejes për ndërtim të obligohet të paraqesë projekt për mënyrën e ngrohjes së objektit, si dhe të parashikohen stimulime për lloje të reja të ngrohjes si klima inverter. Në afat të gjatë parashikohet ndalesë për shfrytëzimin e qymyrgurit gjatë ngrohjes së shtëpive dhe ajo duhet të zbatohet deri në vitin 2021. "Qeveria e miratoi këtë raport në përpilimin e të cilit për herë të parë ishin përfshirë edhe organizatat civile, ndërsa i cili ka të bëjë në ndotjen e ajrit në Republikën e Maqedonisë", tha zëdhënësi qeveritar, Mile Boshnjakovski.

Rritet numri i të punësuarve në industri

Shkup, 29 nëntor - Numri i të punësuarve në industri në muajin tetor të vitit 2017 në krahasim me tetorin e vitit 2016 është rritur për 4.4 për qind, ndërsa në periudhën janar-tetor të vitit 2017, në krahasim me periudhën janar-tetor të vitit 2016 shënon rritje prej 1,8 për qind, kumtoi Enti shtetëror për statistikë. Numri i të punësuarve në sektorin Minierë dhe nxjerrje të gurit në tetor të vitit 2017 në krahasim me tetorin e vitit 2016 shënon ulje prej një për qind, në sektorin Industria e përpunimit rritje prej pesë për qind, ndërsa në sektorin e Furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim rritje për 1.1, për qind. Sipas grupeve të përgjithshme industriale, numri i të punësuarve në industri në tetor të vitit 2017 në krahasim me tetorin e vitit 2016 shënon rritje të Energjia për 03 për qind, Prodhimet intermediare, përveç energjisë për 12.8 për qind, Prodhimet kapitale për 16.8 për qind dhe Prodhimet e përhershme për konsum të gjerë për 1.4 për qind, ndërsa ulje shënon te Prodhimet jo të përhershme për konsum të gjerë për 2.3 për qind.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 29 nëntor - Niveli i arsimit të lartë pritet të ketë në të ardhmen një hallkë të re në zinxhirin e institucioneve që rregullojnë në përgjithësi punën e universiteteve, instituteve dhe palëve tjera të interesit. I konceptuar si urë lidhëse, në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe të gjithë aktorëve pjesëmarrës në nivelin e arsimit të lartë, Këshilli Kombëtar i Arsimit të Lartë (KKAL) pritet të nisë punën jo më larg se shtatori i vitit të ardhshëm. Nëse në muajt janarshkurt miratohet propozimi i Stra-

SEMINAR RAJONAL

Bashkëpunim rajonal kundër terrorizmit

Shkup, 29 nëntor - Nuk është më çështje kyçe nëse është i nevojshëm bashkëpunim, por si dhe në çfarë mënyre së bashku ta intensifikojmë, konceptojmë dhe sistematizojmë në interes të sigurisë kombëtare, rajonale dhe përgjithësi ndërkombëtare, tha zëvendësmministri i Punëve të Brendshme Agim Nuhiu në seminarin rajonal "bashkëpunim i përbashkët rajonal në Evropën juglindore në luftën kundër krimit financiar, me fokus të veçantë të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Të gjithë atë që së bashku e kaluam viteve të fundit, duke përfshirë edhe në lidhje me kërcënimet terroriste, shtoi Nuhiu, më shumë se kurrë më parë na çon te njëri-tjetri, domosdoshmërisht duke i imponuar



kooperativitetin, solidaritetin dhe koordinimin, si dhe parimet fundamentale për ndjekjen e strategjive të përbashkëta për bashkëpunim. "Terrorizmi sot edhe sipas formës dhe sipas përmbajtjes së tij, i ka sendërtuar potencialet personale, veçanërisht duke e globalizuar mbështetjen e vet ideologjike

si mbikombëtare, me çka në mënyrë drastike i modifikon edhe performacat infrastrukturore, logjistike e madje edhe teknike në veprim", theksoi zëvendësmministri. Elaboron edhe pse është i nevojshëm angazhim i përbashkët, kooperativitet për luftë më efektive dhe parandalim nga financimi i krimit

dhe terrorizmit, fokus më i fuqishëm, më i hollësishëm dhe më gjithëpërfshirës ndaj operacioneve financiare kriminalistike. "Jo vetëm për shkak të locimit të kësaj forme të krimit, por edhe për locimin e gjurmëve që mund të na çojnë në terrenin e veprimit terrorist", plotësoi Nuhiu.

Në seminarin rajonal që sot dhe nesër mbahet në Shkup dhe në organizim të misionit të OSBE-së në Maqedoni dhe Ambasadës italiane në RM, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe ekspertëve nga sfera e krimit të financuar nga vendet e EJI-së bisedojnë në shumë tema nga sfera e krimit të financuar me theks të veçantë në financimin e terrorizmit.

PËRGATITJE PËR IMPLEMENTIMIN E KONVENTËS EVROPIANE



SHARRI, MAVROVA..., PEIZAZHE QË DO TË MBROHEN

Në Ligjin për mbrojtjen e natyrës, në të cilin përcaktohet edhe nocioni "peizazh i mbrojtur", tashmë janë të identifikuar disa të tilla, si Parku Nacional i Mavrovës, Mali Sharr, Jabllanica e të tjera, të cilat janë në procedurën e valorizimit

Koha

Evis HALILI

Shkup, 29 nëntor - Konventa evropiane për peizazhin, është një prej katër dokumenteve të rëndësishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, të cilin pritet që së shpejti ta implementojë edhe Maqedonia. Për këtë qëllim u organizua edhe forumi i parë me këtë temë "Sfidat nga implementimi i Konventës Evropiane për peizazhin – trashëgimia kulturore peizazh". Në Ligjin për mbrojtjen e natyrës, në të cilin përcaktohet edhe nocioni "peizazh i mbrojtur", tashmë janë të identifikuar disa të tilla, si Parku Nacional i Mavrovës, Mali Sharr, Jabllanica e të tjera, të cilat janë në procedurën e valorizimit. Por, sipas ministrit të Kulturës, Robert Allagjazovski, implementimi i kon-

ventës do të nxisë zhvillimin ekonomik, pasi menaxhimi dhe planifikimi i mbrojtjes së peizazhit do të kontribuojë edhe me hapjen e vendeve të reja të punës. Ndërsa kompleksiteti i kësaj teme qëndron në procesin e identifikimit të të gjitha peizazheve që luajnë një rol domethënës në mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin e hapësirës.

"Ka shumë arsye që ne të intensifikojmë aktivitetet dhe vepimet konkrete për mbrojtjen e peizazheve kulturore. Ato janë të rëndësishme dhe përbëjnë një interes shoqëror, jo vetëm për kulturën, por edhe për ekologjinë, mjedisin dhe sferën sociale...Për fat të keq, gjatë viteve të kaluara përkushtimi i pakët i organeve kompetente dhe shërbimeve profesionale që kanë në dorë zbatimin e kësaj konvente është evident. Mund t'ju siguroj se Qeveria do të përfshihet seriozisht dhe do të mbështesë të gjitha përpjekjet në këtë domen, me qëllim që sa më shpejt të kemi rezultate konkrete dhe përmirësimin e situatës", ka thënë Allagjazovski.

Në këtë forum zëvendësministri i Mjedi-



Sipas ministrit të Kulturës, Robert Allagjazovski, implementimi i konventës do të nxisë zhvillimin ekonomik, pasi menaxhimi dhe planifikimi i mbrojtjes së peizazhit do të kontribuojë edhe me hapjen e vendeve të reja të punës

tor për realizimin e interesit nacional në kulturë për këtë vit, si edhe është mbështetur edhe nga Delegacioni i BE në Shkup. Kryetari i Ikomos, L Lazar Shumanov, ka kërkuar që të formohet për këtë qëllim një trup koordinativ i përhershëm nga tre ministritë, Kulturës, Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit, si edhe Transportit dhe Lidhjeve.

Paditet avokatja e rreme

Shkup, 29 nëntor - SPB Shkup ka ngritur kallëzim penal kundër 42-vjeçares, J.I. nga Shkupi për shkak të dyshimit të bazuar, se duke u prezantuar si avokate ka mashtruar qytetarë se do t'ua zvogëlojë tatimin e qarkullimit të patundshmërive, ndërsa mjetet financiare që është dashur t'i paguajë për tatim i ka përvetësuar. "Në periudhën nga qershori i deri në gusht të vitit 2017 e denoncuara, duke u prezantuar si avokate gjoja e punësuar në një zyrë avokatie si nëpunëse administrative, me prezantim të rremë dhe fshehje të fakteve, ka mashtruar persona, duke u premtuar në mënyrë të rreme se do t'ua zvogëlojë qarkullimit të patundshmërive, si dhe se do të kryejë pagesë për tatimin e pronës për shtëpinë e një të dëmtuari. Mjetet e marra financiare për shërbimet i ka shpenzuar për nevoja personale, me çka është bërë me dobi pronësore jokushtetuese në vlerë të përgjithshme prej 120.600 denarëve", kumtoi MPB.

Shtyhet sërish gjykimi për vrasjen e vogëlushit Almir Aliu

Kumanovë, 29 nëntor - Është shtyrë gjykimi i djeshëm kundër të akuzuarit Boban Iliq, pas kërkesës të njëres nga palët e kyçura në rast, informuan nga zyra për marrëdhënie me opinionin nga gjykata e Kumanovës. Seanca e fundit, në të cilën do të paraqiten fjalët përfundimtare të prokurorisë dhe mbrojtjes, është caktuar për më 19 dhjetor. Prokuroria e ngarkon të akuzuarin Boban Iliq se më 25 qershor të vitit të kaluar e ka vrarë vogëlushin katërvjeçar, Almir Aliu, pas zënkës paraprake verbale me babain e djaloshit në Shtëpinë e shëndetit në Kumanovë. I akuzuari, ngarkohet se e ka shkelur Almirin katërvjeçar në rrugën "Boris Kidriç". Për ngjarjen e njëjtë kundër tre personave të tjerë, përndryshe babait të djaloshit, Sedat Aliu, Sami Demirit dhe Abdullah Aliut, është parashtruar akuzë për vepër të kryer penale "dhunë".

KËRKESË E TAKIMIT TË MATTO-S

TË LIBERALIZOHET TREGTINË ME TURQINË

Shkup, 29 nëntor - Maqedonia dhe Turqia tërësisht ta liberalizojnë tregtinë me prodhimet ushqimore bujqësore dhe sa më shpejt të hapin dialog të nivelit institucional për bashkëpunim më të madh ekonomik midis investimeve nga të dyja palët dhe paraqitje të përbashkët në tregje të treta, porositën pjesëmarrësit e simpoziumit të sotëm që e organizon Fondacioni për hulumtime ekonomike nga Stambolli. Sipas biznesmenëve, pavarësisht të sinqertë politik nuk as ndryshime, as përparim bilateral të shpejtë, por më e rëndësishme është të ekzistojë stabilitet politik, të funksionojë shteti juridik, të ketë konsistencë dhe si dhe dialog efikas privat publik. "Që të rritet lidhja ekonomike midis Maqedo-

nisë dhe Turqisë të dy qeveritë duhet të konfirmojnë strategji për bashkëpunim të mëtejshëm dhe t'i definojnë prioritetet. Ata më së shumti mund të kontribuojnë në shfrytëzimin e përbashkët të fondeve të BE-së, bartje të përvojës turke për partneritet privat-publik dhe në lehtësimin e procedurave për zhvillim të bizneseve, duke përfshirë qëndrim të përkohshëm dhe punë", theksoi kryetari i Odës Ekonomike Maqedoni-Turqi (MATTO) Ajdovan Ademoski. Ademoski vlerësoi se modernizimi i ekonomisë vendore me pjesëmarrje në nou-haun turk, para së gjithash, në prodhimtarinë industriale dhe bujqësore, ndërtimtari dhe turizëm, shfrytëzim të resurseve të Maqedonisë për shërbime autsor-

sing dhe inkuadrim në zinxhirë global të vlerës së shtuar përmes rilokimit të eksportuesve turq në Maqedoni, janë vetëm disa nga mundësitë për avancim të bashkëpunimit. Është e domosdoshme, nënvizoi Ademoski, kompanitë nga Maqedonia të bëhen sa më të dukshme për kompanitë turke, ndërsa partnerët potencial nga Turqia të marrin informata të cilat do të ishin vendimtare për marrjen e vendimeve afariste për bashkëpunim me Maqedoninë. Ministri pa portofol Adnan Qahil në fjalimin në simpozium potencoi se ekonomia e Maqedonisë është e hapur për bashkëpunim dhe kjo i jep të drejtë, siç tha, të konsiderojë në numër sa më të madh të investuesve të huaj. "Të shikuarit e Maqedonisë si një treg i vogël është e kuar. Maqedonia duhet të shikohet në suaza të BE-së dhe si mundësi për bashkëpunim me vende të treta", tha Qahil, duke shtuar se përveç në zonat e lira ekonomik ku së shpejti të gjitha tatimet janë sjellë në zero, vendi ofron kushte jashtëzakonisht të volitshme edhe në pjesën e investimeve grifild dhe braunfild. Të dhënat e fundit tregojnë se këmbimi tregtar midis Maqedonisë dhe Turqisë është mo-



dest. Në nëntë muajt e parë të këtij viti është 314 milionë dollarë, prej të cilëve vetëm 60 milionë është eksport nga ana e Maqedonisë. "Shënojmë rritje modeste në këmbim prej 4,1 për qind, duke pasur parasysh se sa jemi afër dhe se sa mirë bashkëpunojmë. Eksporti i Maqedonisë por rritet dhe gjithsesi se kjo është mirë, por disbalanci nga ana jonë është serioz", theksoi Antoni Peshev nga oda Ekonomike e Maqedonisë. (F.P)

SISTEM PËR MENAXHIM ME MBETURINAT NË POLLOG



Sipas pjesëmarrësve në nënshkrimin e marrëveshjes, faktori njeri, kapacitetet e dobëta menaxhuese të institucioneve dhe mungesa e masave preventive, janë vlerësuar si faktorët kryesor për pasojat tragjike nga vërshimet e dy viteve të fundit në rajonin e Tetovës

ME NDIHMËN E NDËRKOMBËTARËVE DO TË EVITOHEN VËRSHIMET

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 29 nëntor - Vërshimet që përgjatë dy viteve kanë përfshirë rajonin e Tetovës dhe më gjerë, kanë bërë që autoritetet lokale, së bashku me ato qendrore dhe institucione ndërkombëtare të ndërmarrin hapa preventive për të parandaluar katastrofa në të ardhmen në përmasat që i kishin në vitin 2015 kur kishte edhe viktimat. Së këndejmi, UNDP me financim të Federatës zvicerane, do të financojnë dy projekte të rëndësishme, projektin për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet në rajonin e Pollogut që kap vlerën prej 3.5 milionë franga zvicerane si dhe projektin për renovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të deponisë rajonale Rusino në vlerë prej 1.9 milionë franga zvicerane.

Përfaqësuesja e UNDP-së dhe zëvendës ambasadori i Zvicrës thanë se këto dy projekte lidhen ngushtë pasi mbetjet nga mbeturinat e ngurta, gjegjësisht materialet ndërtimore kanë ndikuar po ashtu në nivelin e lartë të dëmeve që kanë shkaktuar vërshimet e fundit në Tetovë dhe rrethinë.

"Na kujtohen fatkeqësitë të cilat kanë ndodhur para dy viteve, ku humbën jetë 6 persona në Shipkovicë. Unë dhe ekipi im kemi vizituar Shipkovicën që ditën e nesërme. Atë

që kemi parë ishte një fatkeqësi natyrore, pastaj mësuam se shirat ishin aq të rrëmbyeshëm, sa që po ndodhin shumë rrallë, kishte pasur humbje njerëzore, shtëpitë dhe ndërtesat të cilat janë ndërtuar janë shkatërruar për arsye të shirave të rrëmbyeshëm për shkak të mbeturinave të forta, pastaj stacionet hidrometeorologjike që nuk ishin përmbajtur me radhë. Nuk mund t'ia vëmë fajin vetëm natyrës. Përdorja e punonim në Shipkovicë, bashkë me ekipin kemi punuar në gjetjen e zgjidhjeve. Duke bashkëpunuar me kryetarët e komunave, kemi ndihmuar shumë njerëz, gjithashtu kemi vendosur sistemin e lajmërimit të hershëm", deklaroi Luiza Vinton, përfaqësuese e UNDP-së.

Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, tha se projektet në fjalë do të ndihmojnë në menaxhimin e mbetjeve të ngurta që janë konstatuar si shkaktarë të dëmeve të mëdha gjatë vërshimeve, por edhe për forcimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve komunale që janë vlerësuar si pikë e dobët gjatë situatave kritike deri më tani. "Qëllimi i këtij projekti është të nxisë një ndryshim thelbësor në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në rajon, duke përshejtuar tranzicionin nga reagimi aktual ad-hoc reaktiv në përmbytjet, në një sistem të me-

naxhimit të integruar të rrezikut, ndjeshmërisë dhe ekspozimit të popullsisë dhe mallrave, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të përmbytjeve të ardhshme. Ky projekt nuk është vetëm një mundësi për të ofruar zgjidhje afatgjata për zvogëlimin e rrezikut të përmbytjeve në nëntë komuna e rajonit të Pollogut, por gjithashtu paraqet një mënyrë efektive për forcimin e përgjithshëm të kapaciteteve kombëtare të menaxhimit", deklaroi Teuta Arifi, kryetare e komunës. Donatorët theksuan se një pikë e dobët në përballimin me fatkeqësitë natyrore, kanë qenë edhe kapacitetet e dobëta menaxhuese të organeve dhe ndërmarrjeve lokale dhe qendrore. "Kemi këtu menaxhimin e dobët të mbeturinave të forta që rrit rrezikun për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, sidomos mbeturinave të cilat hidhen në lumenjtë dhe kjo lidhet ngushtë me rezistencën ndaj përmbytjeve dhe menaxhimin e mbeturinave të forta. Për këtë Zvicra ka vendosur që të mbështesë realizimin e sistemeve të menaxhimit të mbeturinave të forta. Do ta nënshkruajmë marrëveshjen e parë, do të përgatisim dokumentet teknike për vendosjen e deponisë dhe për zbatimin e masave urgjente. Besojmë se këtë projekt do ta zbatojmë hap pas hapi", deklaroi

Stefan Tomagian, zëvendësambasadori i Zvicrës.

Ministri i Ekologjisë i cili nënshkroi marrëveshjen në emër të Qeverisë, tha se dy projektet e mbështetura nga Qeveria zvicerane do t'i ndihmojnë jo vetëm pushtetit lokal, por edhe forcimit të kapaciteteve të pushtetit qendror për menaxhimin e situatave të përmbytjeve në të ardhmen. "Rajoni i Pollogut është më i prekshëm ndaj këtij lloji të rrezikut natyror, veçanërisht për shkak të ndryshimeve të shpejta klimatike. Vërshimet e fundit katastrofike që përfshijnë këtë rajon dhe pasojat me të cilat u përballem, shtruan nevojën për të trajtuar më seriozisht këtë problem. Ky projekt vjen në momentin e duhur kur institucionet janë të përgatitura si asnjëherë më parë të hyjnë në proces reformash në interes të popullatës. Projektin e shohim jo vetëm si një mundësi unike për të ofruar zgjedhje afatgjate në nëntë komuna e Pollogut, por edhe si një mundësi për të forcuar kapacitetet kombëtare të menaxhimit", theksoi Duraku.

Sipas pjesëmarrësve në nënshkrimin e marrëveshjes, faktori njeri, kapacitetet e dobëta menaxhuese të institucioneve dhe mungesa e masave preventive, janë vlerësuar si faktorët kryesor për pasojat tragjike nga vërshimet e dy viteve të fundit në rajonin e Tetovës.

Dru për ngrohje për familjet me nevojë

Tetovë, 29 nëntor - Në këto muaj të ftohtë të dimrit, Shoqata humanitare "Agimi i Barmirësisë" nga Tetova, ka marrë përsipër që të realizojë një aktivitet humanitarë, siç është shpërndarja e druve për ngrohje për familjet nevojtare. Që nga fillimi i realizimit të këtij aktiviteti e deri më sot, janë shpërndarë rreth 30 metra kub dru për ngrohje për 10 familje. "Nuk ka gjë më të bukur se sa të bëhesh shkak që të ngrohësh zemrat e njerëzve, sidomos në këto kohë të ftohta, andaj krahas shumë aktiviteteve dhe organizimeve të ndryshme që kemi bërë ne si shoqatë humanitare, në këtë kohë kemi edhe projektin dru për nevojtarët, projekt ky që ka filluar të realizohet nga viti i kaluar. Këtë vit deri më tani, ne si shoqatë, kemi siguruar rreth 30 metra kub dru, të cilat janë të ndara nga tre metra për çdo familje, me të vetmin qëllim që të mëshirohemi me nevojtarët dhe të arrijmë atë që i dërguari i Allahut na porositi dhe na thotë se njerëzit më të dashur tk Allahu janë ata njerëz që janë më të dobishëm për njerëzit", tha Ekrem Rufati, sekretar i Shoqatës "Agimi i Barmirësisë". Kjo shoqatë do të vazhdojë që të realizojë këtë projekt edhe në ditët në vazhdim dhe synohet që të ndahen rreth 100 metra kub dru për ngrohje për ato familje, të cilat kanë nevojë. Përveç këtij aktiviteti, kjo shoqatë që nga themelimi ka organizuar edhe një sërë aktiviteteve tjera me karakter humanitarë, si projektin "Miell për nevojtarët", projektin "Synetime falas", prerja e kurbaneve e kështu me radhë. (u.h.)

QIK, 1-9 DHJETOR EKSPOZITË PERSONALE

"Dimensione kohore", nga Bashkim Mexhiti

Shkup, 29 nëntor - "Dimensione kohore", titullohet ekspozita personale e piktorit Bashkim Mexhiti që do të çelet të premten në sallin Imperial në Qendrën Informative të Kulturës. Siç pohon edhe vetë artisti motivet etimologjike të këtyre veprave të përzgjedhura nga krijimtaria e tij pasqyrojnë rrugëtimin e gjatë historik të trojeve tona nëpër kohëra, qëndresën shumëshekullore të periudhave të ndryshme, hyjnizimin e gjuhës, shkrimin e lashtë..., e të tjera. Përndryshe, kjo ekspozitë e tij e radhës

konsiderohet edhe si një lloj homazhi për fatin e kombit shqiptar, që vjen në pah sa përmes penelatave, po aq sa edhe përmes titujve të tablove. Sa i takon konceptit të ekspozitës Mexhiti sqaron se gjithçka e hedhur në tela flet me gjuhën e simbolikës, ndërsa kompozicionet kanë dimensione shpirtërore që shprehin lirikën e dhimbjes, shpresës dhe dashurisë. Bashkimi Mexhiti është profesor në Akademinë e Arteve në Tetovë dhe një prej themeluesve të saj, si edhe anëtar i shoqatës të ar-

tistëve figurativë "Draudacum". Vazhdimisht është prezent në skenën e artit figurativ me prezantime në ekspozita kolektive, biennale të ndryshme të artit, koloni artistike dhe simpoziume arti ndërkombëtare. Ai numëron mbi 13 ekspozita personale brenda dhe jashtë vendit, ku kualiteti i tij krijues është vlerësuar mjaft pozitivisht nga kritika profesionale e artit. Po ashtu, potencialin e vet krijues Mexhiti e ka dëshmuar edhe në një tjetër gjini, skulpturën, ku ka marrë dy çmime, për bocet



e dy veprave, pjesë e "Shkupit 2014", "Pjeter Bogdani" (çmimi i tretë) dhe për "Josif Bagerin" (bashkautor, çmimi i parë). Ai është autor edhe i disa përmendoreve të tjera si "Xhemë Hasës" (Gostivar),

"Aqif Reçanit", "Komandat Tigri" (bashkautor), e të tjera. Bashkim Mexhiti ka lindur në Gostivar, ndërsa studimet e pikturës i ka kryer Akademinë e Arteve në Prishtinë. (E.H.)

“Patatofobia” mban të ndarë Shqipërinë dhe Kosovën



Nga Vladimir KARAJ



Në mbledhjen e katër të përbashkët të mbajtur në Korçë qeveritë e Kosovës dhe Shqipërisë premtuan sërish rrëzim të barrierave kufitare për tregtinë dhe njerëzit dhe firmosën edhe 12 marrëveshje, protokolle dhe memorandume. Kjo e ka çuar numrin e këtyre marrëveshjeve të firmosura në këto takime në 43, që prej janarit të vitit 2014 kur u realizua edhe takimi i parë në Prizren. Mbetet e paqartë se sa kanë ndikuar këto marrëveshje për të përmirësuar qarkullimin e mallrave dhe njerëzve mes dy vendeve, që sipas INSTAT nuk kanë njohur ndonjë ndryshim domethënës prej fillimit të takimeve. Ndërkohë vetë qeveritë kanë humbur numërimin dhe kanë rënë në përsëritje, siç duket të jetë rasti i tre marrëveshjeve për diasporën që u firmosën së fundmi dhe që ishin firmosur edhe më 2015-tën në Tiranë. Enver Robelli redaktor i të përditshme Zviceriane Tagesanzeiger, i tha BIRN duke iu referuar takimit të dy qeverive se shihte “shumë populizëm dhe pak punë konkrete”. “Shumë plane e pak realizim të tyre. Kjo shihet edhe te projektet e infrastrukturës. Rruga e Kombit? E pambaruar. Lidhje hekurudhore? Aspak”, tha Robelli.

Të njëjtin vlerësim dha në një intervistë televizive edhe ish-ministri i Jashtëm Besnik Mustafai. “Pra shumë zhurmë për asgjë, pasi rezultatet kanë qenë shumë të padukshme deri tani. Çfarë është arritur në mbledhjet e kaluara? Pra nuk është bërë një bilanc dhe nuk pati asnjë referencë për marrëveshjet e mëparshme”, tha Mustafai në një bisedë për News 24.

Ecjen e ngadaltë e pranoi edhe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, gjatë konferencës për shtyp me ho-

mologun Ramush Hajradinaj, kur tha se disa prej problemeve të vjetra që këto takime duhej të kishin zgjedhur mbeteshin të pa zgjidhura. “Telashtet te patatet janë telashe të vjetra, që janë më pak sot se dje, por që duhet të jenë zero nesër në krahasim me sot”, tha Rama pasi u pyet nga një gazetar i Kosovës. Por këto probleme ishin ato që priteshin të zgjidheshin që kur u iniciua mbledhje e qeverive. Këtë kishte premtuar Rama në Kosovë, kur e

pati cilësuar atëherë luftën tregtare në dogana si “patatofobi”.

Nga ana e tij Haradinaj, që është i treti kryeministër i Kosovës pas presidentit të tanishëm Hashim Thaçi dhe Isa Mustafës që merr pjesë në këto mbledhje, gjatë të njëjtës konferencë mori përsipër “fajin” nga ana e Kosovës sa i përket unifikimit doganor. “Pala e Kosovës ka ngec, mirëpo jemi në proces dhe do të arrijmë aty”, tha ai.

Me gjithë përparimin e pretenduar prej dy qeverive, mbledhja e katërt e përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës dhe marrëveshjet e nënshkruara në Korçë duken si përsëritje e mbledhjeve të mëparshme, të cilat sollën një bilanc të paqartë arritjesh.



ASNJË NDRYSHIM NË TREGTI

Në shifrat që përmendi Rama në një dekadë marrëdhëniet tregtare mes Shqipërisë dhe Kosovës ishin pësëfishuar. “Në periudhën kohore të këtij 10-vjeçari, tregtia midis dy shteteve tona është mbi pësëfishuar, nga rreth 30 milionë euro në 165 milionë euro”, tha ai. Por siç vetë pranoi shifra “mbetet modeste”, madje kryeministri Rama anashkaloj faktin se ndryshimet në tregti pas fillimit të mbledhjeve të dy qeverive dhe deri te e katërta kanë qenë krejtësisht minimale dhe me luhajtje. Kështu ndër- sa në vitin 2015 eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës u rritën sipas INSTAT nga 18.7 miliard lekë në 2014, në 20.9 miliard lekë, ato ranë sërish vitin që shkoi në vetëm 16.6 miliard lekë.

Importet po ashtu, sipas INSTAT janë luhatur dhe nuk vihet re ndonjë përmirësim. Pas një kulmi në 6 miliard lekë në 2013, ato ranë në 5.9 mld lekë dhe 5.4 mld lekë në kohën që qeveritë realizuan dy takimet e para. Vitin që shkoi importet nga Kosova u rritën sërish në 5.8 miliard lekë, por kjo është një shifër më e vogël se para fillimit të takimeve mes dy qeverive. Sipas të dhënave statistikore shkëmbimet mes dy vendeve mbeten minimale. Ndërkohë marrëveshja më e

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 29 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

rëndësishme e cila ka kaluar edhe në kuvendet reciproke, ajo për linjën interkonjeksionit 400 kilovolt, mbetet e bllokuar nga Beogradi, dhe nuk dihet ende kur mund të bëhet operative.

'DEJA VU' MARRËVESHJESH, MEMORANDUMESH DHE PROTOKOLLESH

Ndërsa është e qartë se si arritje të këtyre takimeve palët do përmendin hapjen e dy konsullatave të përbashkëta në Milano dhe Muni dhe angazhimin në projekte kulturore të përbashkëta apo edhe realizimin e një abetareje të përbashkët, për pjesë tjetër të marrëveshjeve dhe protokolleve është e pamundur të gjurmohet sa janë realizuar. BIRN gjeti se veç marrëveshjes së interkonjeksionit të ratifikuar në kuvendet reciproke, marrëveshjet e tjera si ajo për shmangien e tatumit të dyfishtë, janë publikuar në fletoren zyrtare të Shqipërisë, por as aty nuk bëhet e qartë nëse kanë hyrë në fuqi apo jo. Po ashtu për një pjesë të marrëveshjeve është e pamundur të gjendet përmbytja dhe qëllimi. BIRN gjeti ndërkohë se kishte përsëritje në marrëveshjet e deklaruara si të firmosura edhe më herët. Në mbledhjen e fundit që vendosi si prioritet diasporën u nënshkruan sipas njoftimit të dy qeverive tre marrëveshje mes dy vendeve ku flitet për bashkëpunim sa i përket diasporës. Kështu u nënshkruan marrëveshja për "financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë"; "për bashkëpunimin në fushën e diasporës" dhe "për qendrat kulturore (të përbashkëta) në diasporë".

Por dy qeveritë siç del edhe nga ky njoftim i vitit 2015 kishin nënshkruar të njëjtat marrëveshje me të njëjtat qëllime të cilat u përsëritën duke ndryshuar emrat e ministrave dhe ministrive firmosëse. Kështu në 2015 u nënshkrua "ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës "Për Organizimin e Përbashkët të Mësimin të Gjuhës Shqipe dhe të Kulturës Shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë" dhe po ashtu edhe memorandum i bashkëpunimit "ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës". Memorandumi njësor si marrëveshja e nënshkruar së fundmi në Korçë, i kishte vënë vetes qëllimin e krijimit të qendrave kulturore të përbashkëta. "Ky Memorandum synon nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në programet "Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë" dhe themelimit të përbashkët të "Qendrave Kulturore në Diasporë", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Kulturës. Të formuluar ndryshe duken edhe një sërë memorandumesh për shkëmbim eksperiencash apo për ndihmë të ndërsjellët në marrëdhëniet me jashtë. Marrëveshje konkrete duket vetëm ajo e njohjes së pagesave për pension në dy anët e kufirit, marrëveshje që Shqipëria e ka nënshkruar ndërkohë me disa vende të tjera. (birm)

Këndonjësve

Nukë munt t'a mohojmë se Shqipëria jonë gjendet sot në një situatë delikate, të vështirë. Ankimet janë të shumë dhe çdo njeri pandeh se diagnostikon sëmundjen dhe gjen ilaçin duke u ankuarë; kujton se qarja e shëron lëngatën. Kujdesi më i parë i atyreve që shohin të keqen dhe rezikun, ka qënë qysh të ngarkojnë dokë me faj. Pandehin se me këtë mënyrë çduket e liga dhe shpëton vëndi. Të tjerë gjendenë që as mejojnë fare, as shohin, se nuk shikojnë.

Artikujt që po pasojnë s'janë as për të parët, as për të dytët. Janë shkruarë vetëm për ata që shikojnë, që vënë veshin të dëgjojnë, që duan të lodhen, të kupëtojnë përgjegjësinë e tyre personale. Qarja më e madhe sot në Shqipëri është prej situatës ekonomike, nga shkuarja dhe rrojta që u bë fort e rëndë. Varfëria që mbretëron sot në vëndin tënë s'është një sëmundje më vete: është shënja, simptoma e një lëngate më të madhe, mbase dhe e shumë sëmundjeve. Pa diturë shkaku, pa gjeturë rrënjën, nuk munt që t'i heqim një mur së ligësë.

Faji më i madh, burrimi i kësaj që vuajmë, është se, kushdó prej nesh j'a heh fajin t'jatrë; as kush nukë do që të marrë një përgjegjësi përsipër. E pret nga t'jatrë kush ndreqjen e të metave, shpëtimin prej çdo pësimi. Bëjmë sikur harojmë që Shqipëria është shtëpia jonë dhe që ne vetë do t'a ndreqim dhe t'a vëmë jashtë valëve të shtërgatësë. Shqipëria, sot vëndi më i varfëri i dheut, është dhe ay më i shtrënjti, ku jetesa kushton më teprë se tekdó gjetkë. Burrimet e fitimit po rrinë të mëshelë, ku se nga çdo anë shpenzimet gjejnë rëke të ra.

Cjithë vuajnë dhe qahenë. Po kujtojnë se një fuqi e huaj, një krah

prej qielli, do t'i nxierë nga e keqja. Të dy krahët e vetë s'i mejtón kush. U pëlqen më mirë të eksploatojnë një të tretë, se sa të pshtetenë mbi fuqin e tyre personale. Shtrenjtësi e jetësë na bën të vuajmë, se rrojmë keq, dhe me shumë mundime. Dhe s'mejtojmë cilin burrim prej pasunive që ka dheu ynë duhet që të përdorim. Shqipëtarë, thonë, rron me bujqësinë dhe bagëtinë. Unë do të shtonj një mjeshtëri të tretë: Kurbeti. Që të shpëtojmë nga varfëria duhet që të harrojmë kurbetin, të pakësojmë "çobanllëkun", të shtojmë bujqësinë. Duke u liruarë buka do të lirohet dhe jeta.

Vëndi qahetë nga mungesa e tregtisë, gjë fort e natyrisht me qënë se Shqipëtarë sot nukë ble asgjë, nukë shpenzón as një ovull. Shqipëtarë nuk harxhon, se nuk fitón. Nukë fitón se nuk e ndien nevojën e një jete të ëmbël; pra nuk punón. Kur të punojë "robi" dhe të begatohet, atëherë do të zërë të zhillohetë dhe industria, pa të cilën nuk munt të kemi kurrë një prehje ekonomike. Po Shqipëria vuan prej një lëngate më të madhe që po i brin eshtërat: popullimi. Ne kjo e gjej rezikun më të math që na ka hipurë mbi krye, që na kanoset ekonomikërisht dhe politikisht, se po shkakton dobësin tonë materiale dhe morale.

Të shtuarët e popullsisë është për neve një çështje jete; me të tetëqind mijë e ca banorët që kemi sot, jemi duke formuar vëndin më të varfrë dhe Shtetin më të dobët të dheut; në mos i dhëshim kësaj çështjeje importencën që meritón, pritmi ynë me të vërtet vizatohet në ngjyra të errëta. Çështja kaq' importente dhe vitale e popullëzimit është lidhur me atë të shëndetësisë dhe të shoqërive bamirëse, më teprë akoma me krijimin e shoqërive të

gravet. Në qoftë se nukë zgjojmë mëmën, djalin e kemi dënuarë për vdekje. Që të shpëtojmë prej greminës dhe të sigurojmë një lumtëri, duhet të këqyrim plagën tënë drejt për drejt, të interesohemi, të përiqemi, të reaktujmë.

Po rrojta e një populli, mbajtja dhe lulëzimi i një kombi, i një Shteti, s'është vetëm me mjete materiale; kërkón dhe një shumicë kondita morale, një fuqi të mëndjesë dhe të shpirtit, që sigurojnë përrimin dhe qytetërimin, që e bëjnë atë komb dhe atë Shtet të zërë një vënd të ndershmë në shoqëritë e sotme. Fuqija morale dhe shpirtënore është ajo që siguron edhe pushtetën materiale, mirëshkuarjenë fizike. Në këtë të paka faqe kam radhiturë një diagnostik. Si çdo plagë, edhe tonatë shërohenë. Dëshëronj që, kur të bierë kjo broshurë në duart e këndonjësve, plagët tona të jenë vetëm një kujtim. Çdo njeri që rron detyrohet të shërojë trupin e tij.

Ilaçi është aktiviteti material dhe moral. Aktiviteti është puna, dhe puna bëhetë me vullnet dhe me dashje. Puna s'është shorta e një njeriu, e një palë të njerëzve: është pjesa e të gjithëve.

Ftonj këndonjësit e mij të kupëtojnë mirë barën që u bie: të mos e pandehnjë askush vetëhen' e tij lark çështjesë; flas për të gjithë. Të lutem edhe ty, e dashurë këndonjëse, të meditosh mbi detyrën e madhe që ke, mbi shërbimin e math që munt të bësh.

Çdo shqipëtar gjendetë sot përpara gjykatores' së historisë. Historija po na gjykón: në mos patmë fatin të jemë stërniprë të lumturë të stërgjyshëvet fatosë, kemi detyrën të përiqemi që të bëhemi, ne vetë, stërgjyshër të ndershmë për nipët tanë. (Botuar më 1924)



Nga Mit'at FRASHËRI




Çdo shqipëtar gjendetë sot përpara gjykatores' së historisë.

Historija po na gjykón: në mos patmë fatin të jemë stërniprë të lumturë të stërgjyshëvet fatosë, kemi detyrën të përiqemi që të bëhemi, ne vetë, stërgjyshër të ndershmë për nipët tanë



PROTEZA PËR TË PËRMIRËSUAR KUJTESËN

Është një implant i trurit që stimulon modelet e aktivitetit elektrik të shoqëruara me performancën më të mirë mnemonike, duke rritur aftësinë për të kujtuar edhe 25%



Një implant i bazuar në elektrodat e trurit duket se përmirëson aftësinë për të kujtuar, sepse ai imiton aktivitetin natyror të kodifikimit të përvojave të trurit. Operacioni i protezës së parë të kujtesës u ilustrua gjatë një takimi të kohëve të fundit të Shoqatës së Neuroshkencës, në Washington. Është një implant i trurit që stimulon modelet e aktivitetit elektrik të shoqëruara me performancën më të mirë mnemonike, duke rritur aftësinë për të kujtuar edhe 25%.

HAPI 1: TË KOPJOSH. Së pari, implanti regjistroi aktivitetin e trurit të vullnetarëve të angazhuar tek kujtesa afatshkurtër (aftësia për të mbajtur mend për pak çaste një numër të kufizuar informacioni) dhe tek kujtesa e punës: kjo e fundit përfshin atë në afatin e shkurtër dhe përdor informacionin e marrë në konsideratë në këtë lloj "depoje të përkohshme" për të ndërtuar argumente më komplekse.

HAPI 2: TË FORCOSH. Shkencëtarët kanë identifikuar



Shkencëtarët kanë identifikuar modelin e aktivitetit elektrik të lidhur me rezultatet më të mira mnemonike dhe kanë përdorur elektrodat për ta riprodhuar atë artificialisht në trurin e pjesëmarrësve gjatë testeve të mëvonshme

modelin e aktivitetit elektrik të lidhur me rezultatet më të mira mnemonike dhe kanë përdorur elektrodat për ta riprodhuar atë artificialisht në trurin e pjesëmarrësve gjatë testeve të mëvonshme. Në veçanti, goditjet e vogla elektrike u administruan në hipokampus, që është një rajon thelbësor për mësimin dhe mbajtjen e kujtimeve. Ky stimulim ka përmirësuar kujtesën afatshkurtër me 15% dhe kujtesën e punës me rreth 25%.

E ARDHMJA. "Po shkruajmë kodin nervor për të rritur funksionalitetin mnemonik", ka deklaruar Song për New Scientist, duke sh-

tuar se implante të ngjashme një ditë mund të shërbejnë për të forcuar edhe vizionin apo lëvizjen. Një mundësi tjetër është që një ditë ata mund të përdoren për të furnizuar deficitet mnemonike të pacientëve që vuajnë nga demenca, si për shembull sëmundja Alzheimer. Dong Song (prof. i Inxhinierisë Biomjekësore, Universiteti i Kalifornisë) ka testuar pajisjen në 20 vullnetarë, të cilët tashmë kishin elektrodat të implantuara në tru për trajtimin e epilepsisë - për të kapërcyer, në këtë fazë të studimit, çështjen e "fiksimit" të pajisjes, që është një operacion invaziv.

Roboti super i vogël që do të trajtojë kancerin



Robotë të vegjël shumë shpejt do të përdoren për të trajtuar kancerin në pjesë të vështira të trupit. Shkencëtarët kanë krijuar një grup makinerish mjaft të vogla "biohibride", që janë në përmasën e një rruazë e kuqe gjaku. Gjatë testimit fillestar, robotët u drejtuar magnetikisht në zonat e stomakut të minjve, ku vranë tumoret kanceroze dhe duke lënë të padëmtuara qelizat e shëndetshme. Shkencëtarët shprejnë se e njëjta teknikë duhet të përdoret tek njerëzit për të vendosur ilaçin në zonën e duhur. Robotët u krijuan nga një skuadër ndërkombëtare shkencëtarësh të drejtuar nga Universiteti kinez i Hong Kongut, duke lidhur algat e vogla me pjesë magnetike. Doktor Qi Zhou, një nga autorët e studimit, thotë se këta robotë super të vegjël mund të përdorin në një sërë mënyrash, përfshi diagnostifikimin e sëmundjeve, dhe ndihmë në terapinë e pjesëve të trupit që janë të vështira për t'u trajtuar.

Vajza 3 vjeçe shkon në kopsht, i bën edukatores dhuratë një qese marijuanë

Një fëmijë 3 vjeçe në Bari të Italisë, i ka bërë edukatores së tij një dhuratë mjaft të veçantë. Sapo mbërriti në klasë, ajo i dorëzoi asaj një qese me marijuanë. Staf i kopshtit menjëherë informoi policinë, e cila kishte ndërhyri menjëherë për të marrë dozën e hashashit. Më pas policia shkoi në banesën e prindërve të vogëlushes. Në banesë ishte babai dhe gjatë kontrollit, agjentët e policisë sekuestruan edhe 2 gram të tjera marijuanë. 31-vjeçari me kombësi nigeriane, po hetohet në gjendje të lirë nën akuzën e posedimit të lëndës narkotike.

Amazon e bën Jeff Bezos njeriun 100 miliardë dollarësh

Nëse ishe një nga miliona blerësit në Amazon, të premten e zezë, atëherë urime...ke kontribuar që Jeff Bezos të bëhet një njeri që vlen 100 miliardë dollarë



Themeluesi dhe aksionisti më i madh i Amazon, arriti në rekordin me 12 shifra për të parën herë sipas Bloomberg, një nga dy shërbimet kryesore që vlerësojnë pasurinë e më të pasurve të botës në kohë reale. Forbes, shërbimi tjetër, vendos përkrah emrit të tij shifrën

e 99.6 miliardë dollarëve. Aksionet e Amazon u rritën me 2.5 për qind të premten, duke e vendosur Bezos në krye. Ato u rritën edhe si pasojë e raporteve se shitjet online për ditën e Falenderimeve dhe të Premten e Zezë u rritën 18 për qind krahasuar me vitin e shkuar.

Bezos ka fituar rreth 2.4 miliardë dollarë vetëm gjatë të premtes së zezë. Ai zotëron 78.9 milionë aksione të Amazon me vlerë 93.6 miliardë dollarë. Kjo nuk përfshin të gjitha zotërimet e tij edhe pse dy kompanitë e tjera të profilit të lartë që ai ka në pronësi, Washing-

ton Post dhe kompania e turizmit hapsinor Blue origin, nuk kanë të njëjtën peshë kur bëhen krahasime. Vetëm këtë vit, aksionet e Amazon janë rritur me 58 për qind, mjaftueshëm për të pasuruar Bezos me afro 34 miliardë dollarë. Në fakt, fitimi i një dite të vetme prej 2.4 miliardë dollarësh, do të mjaftonte për t'i dhënë atij kreun e listës së Forbes për 1 mijë personat më të pasur në planet. Bezos e fitoi titullin e njeriut më të pasur në botë në korrik, kur kaloi për pak kohë Bill Gates. Ai u zhvendos sërisht në vend të dytë në tetor. Tani, themeluesi i Microsoft ka një pasuri prej 89 miliardë dollarësh sipas Forbes dhe Bloomberg. Gates besohet se është i vetmi person tjetër në glob që ka arritur shifrën e 100 miliardë dollarëve, në 1999.

Policia zbulon tonë me vaj luledielli, të shitur si vaj ulliri

Policia në Greqi ka arrestuar shtatë vetë që kanë ngjyer me të gjelbër tonë të tëra vaj luledielli dhe e kanë shitur si vaj ulliri. Prokuroria greke bëri të ditur të dielën se në Greqi janë shitur shumë tonë vaj luledielli si vaj ulliri. Ajo akuzoi shtatë persona, që e kanë ngjyer vajin e lulediellit të verdhë në ngjyrë të gjelbër, në mënyrë që të duket si vaj ulliri. Ky vaj i fal-

sifikuar është eksportuar edhe në Gjermani. Policia arrestoi të dyshuarit - një familje me katër anëtarë dhe tre të afërme - në qytetin Larissa. Vaji i falsifikuar u është shitur në enë pesëlitrëshe konsumatorëve grekë dhe është eksportuar në mbajtëse një tonëshe vaji, kryesisht në Gjermani. Policia gjeti në vend pesë tonë vaj të falsifikuar, i cili nuk qe paketuar

ende dhe dymbëdhjetë mbajtëse, të destinuara për eksport. Produkti shitej si "Vaj ulliri ekstra i pastër, direkt nga prodhuesi". Në Greqi, një vaj i vërtetë i tillë kushton nga 26 deri 30 euro. Policia pati arrestuar më parë rreth 60 tregtarë të vajit të falsifikuar dhe vetëm më vonë konstatoi se ku ndodhej qendra e dyshuar e mashtrimit.



MESHKUJT QË PUNOJNË NATËN RREZIKOHEN NGA KANCERI I PROSTATËS



Pos sëmundjes së kancerit në prostatë, meshkujt të cilët punojnë në ndërrimin e natës rrezikojnë të preken nga tumori në zorrë, fshikëz dhe në mushkëri

Në hulumtim kishin marrë pjesë 3137 meshkujt të cilëve u ishte diagnostikuar një lloji i kancerit. Rezultatet kanë treguar se shumica prej tyre gjatë një periudha kohore kishin punuar në ndërrimin e natës

Meshkujt që punojnë në ndërrimin e natës, sipas një studimi të kryer në Kanada, tri herë kanë më shumë gjasa të preken nga kanceri i prostatës, në krahasim me ata që punojnë në ndërrimin e ditës. Besohet se gjatë ndërrimit dhe punës natën çrregullohet prodhimi i melatoninës, hormoni i cili ndihmon në rregullimin e gjumit. Kur trupi ynë është ekspozuar ditës, prodhimi i melatoninës zvogëlohet duke nxitur lëvizjen e shumë proceseve në trupin tonë, të cilën e ndihmojnë në zhvillimin e tumoreve. Në hulumtim kishin marrë pjesë 3137 meshkujt të cilëve u ishte diagnostikuar një lloji i kancerit. Rezultatet kanë treguar se shumica prej tyre gjatë një periudha kohore kishin punuar në ndërrimin e natës. Në stadtet e hershme, kanceri i prostatës nuk jep shenja klinike. Në stadtet më të avancuara, shfaqen shenja klinike, si urinim i shpeshtë, sidomos natën; urinim i dobët, jo me forcë; ndërprerje e menjëhershme e urinimit, si dhe rifillim i urinimit mbas disa sekondave; dhembje dhe djegie gjatë urinimit; urinim me gjak, shoqëruar shpesh me copëza të vogla gjaku të mpiksuar; prezencë e gjakut në spermë; dhembje të lokalizuara në një ose disa kocka,

sidomos në kockat e legenit dhe në vertebrat, dhembje që vazhdojnë pa ndërprerje të paktën deri në dy javë, shenja e kancerit të avancuar që tregon se ka prekur kockat. Shenjat klinike të kancerit të prostatës nuk duhet të keqinterpretohen nga personat që kanë shenja të tilla e përipien të realizojnë një vetëdiagnostikim, pasi këto shenja takohen edhe në sëmundje të tjera të prostatës me origjinë jo kanceroze. Pos sëmundjes së kancerit në prostatë, meshkujt të cilët punojnë në ndërrimin e natës rrezikojnë të preken nga tumori në zorrë, fshikëz dhe në mushkëri. Edhe pse hulumtimet e mëhershme kanë sugjeruar se puna natën më shumë i dëmton femrat, studimet e shkencëtarëve nga universiteti Kuebek tregojnë se edhe meshkujt janë të rrezikuar po aq sa edhe femrat. Organizmi i njeriut ka orën e tij biologjike që do të thotë se ai e ka të programuar kohën e gjumit për gjumë dhe kohën e punës për punë. Kështu gjatë eksperimenteve, analizat e gjakut treguan se 6% i normal i gjeneve të ADN-së janë specifikisht më shumë apo më pak aktive, në periudha të ndryshme të ditës. Që kur vullnetarët nisën të punonin gjatë natës, ai rregullim i duhur gjenetik nisi të humbiste.

Vitamina E, një aleat i çmuar i shëndetit tonë



Vitamina E është një aleat natyral për shëndetin e trupit tonë: përveç që është një antioksidant i fuqishëm i aftë për të luftuar efektin e dëmshëm të radikaleve të lira dhe plakjen qelizore, është tejet e rëndësishme për të luftuar sëmundjet kardiovaskulare dhe koronare të zemrës, për shembull duke shmangur mpiksjen e gjakut, të cilat mund të çojnë në formimin e trombeve. Por kjo nuk është e gjitha: le të zbulojmë se ku dhe si mund ta marrim këtë vitaminë të çmuar dhe çfarë përfitimesh kemi. Një nga detyrat kryesore të vitaminës E është mbrojtja e trupit tonë duke forcuar mbrojtjen imunitare: mbron indet nga radikale të lira, mbron nga dëmet që shkakton ndotja, është e dobishme për të luftuar çrregullimet e lëkurës të tilla, si aknet dhe ekzema; është një ndihmë e vlefshme në komplikimet diabetike, është efektive kundër sëmundjeve gastrointestinale dhe është një aleat i mirë kundër sindromës premenstruale. Vitamina E gjithashtu zbut inflamacionin kronik dhe çmendurinë senile. A është e mjaftueshme? Prandaj është e rëndësishme që të bëni një përcjellje natyrore të kësaj vitamine të çmuar: tani është e njohur se mirëqenia e organizmit tonë fillon nga tavolina dhe nga ajo që hamë çdo ditë. Vaj për vaj: për të siguruar një furnizim të mirë të vitaminës E, është e nevojshme të konsumojmë farat dhe të gjitha vajrat vegjetalë që janë nxjerrë prej tyre si, për shembull, vaj luledielli, vaj badiava, vaj kërp ose vaj farë liri. Këto vajra janë jashtëzakonisht të pasur me tokoferol, përbërësin më të vlefshëm të kësaj vitamine fantastike.

MIQTË E GJELBËR: perimet dhe frutat, si dhe drithërat, janë të mbushura me vitaminë E. Por sigurisht perimet me gjethe jeshile, për shembull spinaq, brokoli, lakra, rrepa; ndërsa tek frutat avokadoja është një minierë e vërtetë.

KURRË PA: frutat e thata, përveçse të mira, janë me të vërtetë të çmuara. Ngrënia e tyre na pengon të hamë ushqime me kalori të lartë apo me vlera ushqimore. Frutat e thata, dhe sidomos arrat, lajthitë, fistikët dhe bajamet, na furnizojnë edhe me vitaminën E.

Është shumë e dobishme në parandalimin e sëmundjeve të zemrës dhe kancerit dhe gjithashtu një antioksidant i fuqishëm. Ja cilat janë ushqimet që e përmbajnë këtë vitaminë



Në bazë të nenit 19 të Statutit të Operatorit të sistemit elektropërçues të Maqedonisë – Shoqëria aksionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin e energjisë elektrike të Maqedonisë në pronësi të shtetit Shkup – SH A MEPCO, ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 21/2008), ndërsa në lidhje me nenin 67, paragrafi 13 i Ligjit për energjetikë i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare 16/2011), Rregullat për sigurim të energjisë elektrike për mbulim të humbjeve në sistemin elektropërçues të Republikës së Maqedonisë të lejuara me Vendimin e KRE nr. 02-1869/1 të datës 10.11.2017 dhe nenit 192 të Ligjit për furnizime publike (Gazeta Zyrtare nr. 136/2007.... dhe 192/2015), SH A MEPCO publikon:

FTESË PUBLIKE PËR DORËZIM TË OFERTËS JP-01/2017

Të nderuar,

Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë – Shoqëria aksionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin e energjisë elektrike të Maqedonisë në pronësi të shtetit Shkup – SH A MEPCO realizon procedurë për ndarje të marrëveshjes për furnizim të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin elektropërçues të Republikës së Maqedonisë në vitin 2018 me ftesë publike për dorëzimin e ofertave me publikimin e shpalljes numër JP – 01/2017 në pajtim me Rregullat për mënyrën dhe procedurën për realizim të furnizimit publik të lejuar nga Komisioni rregullator i energjetikës.

Ju lutemi të dorëzoni ofertën Tuaj për lëndën e lartpërmendur të marrëveshjes për furnizim të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin elektropërçues të Republikës së Maqedonisë në vitin 2018, më së voni deri më 07.12.2017 në ora 11.00 (sipas kohës lokale) përmes postës në adresë ose personalisht duke e dorëzuar të në arkivin e SH A MEPCO.

Me këtë ftesë në ueb faqen e SH A MEPCO - www.mepso.com.mk, do të publikohet edhe dokumentacioni për ftesën publike i cili përmban të gjitha informatat të cilat do t'ju ndihmojnë për përpilimin e ofertës. Dokumentacioni do të përbëhet nga pjesët në vijim: instruksione për ofertuesit, specifikimet teknike, modeli i marrëveshjes dhe formulari i ofertës.

Ofertuesit, Dokumentacionin e kompletuar dhe PAKON e Dokumenteve për aplikim, mund ta marrin në lokalet e SH A MEPCO, rr. "Maksim Gorki" nr. 4, Shkup, kati III, prej ora 11.30 deri në ora 14.30, ose me kërkesë të tyre mund t'u dërgohet me postë, ku duhet të dorëzohet dëshmi për pagesën e realizuar në shumë prej 50,00 euro në llogarinë:

- Llogaria në denarë: 530010100845304 – Ohridska Banka Shkup ose
210059337810365 – Tutunska Banka Shkup ose
200001086598648 – Stopanska Banka Shkup ose
320000000076830 – Centralna Kooperativna Banka Shkup
 - Llogaria devize: IBAN: MK 07530901000383053,
SWIFT: OHRDMK22; Ohridska Banka Shkup,
 - Numri i llogarisë: 1470100038307
- Me shenjë për pagesë: për Ftesë publike nr. JP-01/2017

Adresa: rr. Maksim Gorki nr. 4, 1000 Shkup Republika e Maqedonisë,
Kontakt personi: Darko Dokuzovski, tel: ++ 389 71 229 430,
Posta elektronike: darkod@mepso.mk,

Hapja e ofertave do të jetë publike dhe do të realizohet më 07.12.2017 në ora 11.00 (sipas kohës lokale) në lokalet e SH A MEPCO në rr. Maksim Gorki nr. 4 Shkup R. Maqedonisë.

SH A MEPCO – Shkup



Pursuant to Article 19 of the Transmission System Operator of Macedonia – Joint Stock Company for Electricity Transmission and Power System Control of Macedonia in state ownership Skopje (AD MEPCO), (Official Gazette of R.M. no. 21/2008), and Article 67 item 13 of the Energy Law (Official Gazette of R.M. no. 16/2011), Rules and method of conducting public procurement approved by Energy Regulatory Commission of the Republic of Macedonia with decision No. 02-1869/1 from 10.11.2017, and article 192 of the Energy Law (Official Gazette of R.M. 136/2007, ... and 192/2015), AD MEPCO announces:

PUBLIC TENDER NOTICE JP 01/2017

Dear Sirs,

The Transmission System Operator of Macedonia – Joint Stock Company for Electricity Transmission and Power System Control of Macedonia in state ownership Skopje (AD MEPCO), shall conduct contract award procedure for electricity for covering electricity losses within the Macedonian Electricity Transmission System in 2018 by public Tender Notice No: JP – 01/2017 under the Rules and method of conducting public procurement approved by Energy Regulatory Commission of the Republic of Macedonia.

You are kindly requested to submit your Documentation for an Open Invitation to Bid for the above contract award on electricity for covering electricity losses within the Macedonian Electricity Transmission System for 2018 by of December 07, 2017 at the latest at 11 o'clock a.m. (local time) by mail/courier at the below address or in person handing the procedure over in AD MEPCO Archive.

This Open Invitation to Bid notice shall be put on AD MEPCO web site accompanied by the Documentation for an Open Invitation to Bid containing all information to help you prepare the Open Invitation to Bid. The Documentation comprises of Instructions to Tenderness, Technical Specifications, Draft (sample) Contract and Tender Form.

The set of Documentation for an Open Invitation to Bid and set of Application Documentations, Bidders may provide in AD MEPCO premises 4 Maksim Gorki St., 1000 Skopje, Republic of Macedonia, floor III, from 11:30 to 14:30 a.m. or upon their request may be delivered by mail prior to enclosing a proof of Euro 50,00 payment effected on the following .account:

- account in denars: 530010100845304 – Ohridska Banka Skopje, or
210059337810365 – Tutunska Banka Skopje or
200001086598648 – Stopanska Banka Skopje or
320000000076830 – Centralna Kooperativna Banka Skopje
 - account in foreign currency: IBAN:MK 07530901000383053,
SWIFT: OHRDMK22; Ohridska Banka Skopje
 - account number: 1470100038307
- with a notice: Payment for Public Tender Notice no. JP-01/2017

Address: 4 Maksim Gorki St., 1000 Skopje, Republic of Macedonia,
Contact persons: Darko Dokuzovski, phone: ++389 71 229 430,
e-mail: darkod@mepso.mk

Tender Opening shall be public and held on December 07, 2017 at 11 o'clock a.m. (local time) in AD MEPCO premises, 4 Maksim Gorki St., 1000 Skopje, Republic of Macedonia.

AD MEPCO -Skopje



Në bazë të nenit 54, 63, 64, 125, 127, 131, 132, 133 dhe 134 të Ligjit për arsim sipëror, nenit 3 paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në Sektorin publik, dhe nenit 22 paragrafi 3 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune

UNIVERSITETI "GOCE DELLÇEV" – SHTIP Publikon KONKURS

Për zgjedhjen e mësimdhënësve të njësisve në kuadër të Universitetit

1. FAKULTETI I BUJQËSISË

1.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:
-Fiziologjia e bimëve/Kopshtaria - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

2. AKADEMIJA MUZIKORE

2.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:
-Llojet e instrumenteve – Piano dhe Sonologjia - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

Kriteret për zgjedhjen:

-Për docent mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, sukses mesatar prej së paku tetë në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për secilin cikël veç e veç, së paku katër punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose dy punime shkencore në revistë shkencore me faktor në pesë vitet e fundit, arritje në aplikimin e rezultateve hulumtuese dhe aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevalumimi. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për profesor me korrespondencë mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, së paku pesë punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose tre punime shkencore në revistë shkencore me faktor në pesë vitet e fundit, pjesëmarrje në projekte shkencore-hulumtuese, gjeësisht arritje të theksuara në aplikimin e rezultateve hulumtuese, kontribut në aftësimin e mësimdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevalumimi. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për profesor të rregullt mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, së paku gjashtë punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose katër punime shkencore në revistë shkencore me faktor në pesë vitet e fundit, i cili ka marrë pjesë ose ka udhëhequr në projekte shkencore-hulumtuese dhe ka dhënë kontribut në aftësimin e mësimdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevalumimi. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për docent, profesor me korrespondencë dhe profesor të rregullt për lëndët profesionale-artistike mund të zgjidhet edhe person i cili nuk ka shkallë doktor i shkencave, i cili ka të mbaruar arsim të lartë përkatës nga shkalla e dytë, vepra të pranuar artistike dhe profesionale gjeësisht arritje të cilat janë të rëndësishme për afirmimin e kulturës dhe artit në dhe jashtë vendit si dhe aftësi për punë mësimore. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

- Orari i kohës së punës dhe pagesa:
- Orari ditor i punës prej 08:30h. deri 16:30h.
- Orari javor i punës – 40 orë punë (prej ditës së hënë deri në ditën e premte)
- Neto paga themelore për: Docent -38.143,00 den.; Profesor me korrespondencë - 43.660,00 den.; Profesor i rregullt - 50.311,00 den;

Dokumentet e nevojshme për kandidatët për zgjedhjen në titujt mësimor dhe mësimor – shkencor:

- fletëparaqitje;
 - diplomë për arsim të mbaruar përkatës – për punim të mbrojtur të magjistraturës/doktoraturës (një kopje të diplomës në origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter, diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuar me ekuivalencë të notave);
 - certifikatë për provim të dhëna të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve
 - biografi të shkurtër (në katër kopje);
 - listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale
 - nga një kopje të punimeve;
 - vërtetim se një një prej gjuhëve të huaja
 - rekomandim prej së paku 2 (dy) profesorëve (me korrespondencë/ rregullt) nga sfera përkatëse shkencore për të cilin bëhet zgjedhja - për kandidatët për docent;
 - rekomandim nga punëdhënësi paraprak (nëse kandidati ka qenë i punësuar) - për kandidatët për zgjedhjen docent;
 - një kopje të punimit të magjistraturës/doktoratës;
 - certifikatë të shtetësisë;
- Konkursi zgjatë 8 ditë pune nga dita e publikimit.
Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë në nenin 131 të Ligjit për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit).
Dokumentet të dorëzohen në arkivin e:
1. Fakulteti i bujqësisë – rr. "Goce Dellçev" nr. 89, Shtip; tel. 032-550-600;
2. Akademia muzikore - rr. "Cvetan Dimov" pn, Shtip, tel. 032-550-200;
Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/16, 127/16), dhe nenit 34, paragrafi 2 i Ligjit për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 274/13 – teksti i pastruar), Fakulteti matematiko-natyror në Shkup, shpall

KONKURS

për zgjedhjen të titujve mësimore-shkencore, titullar dhe bashkëpunues

INSTITUTI PËR BIOLOGJI

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: zoologji dhe zoofiziologji, entomologji dhe ekologji (sistematika dhe filogjenia e pakurruarëve, entomologjia forensike dhe evolucionin organik)
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.
 2. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: zoologji dhe zoofiziologji, (citologji, histologji dhe embriologji)
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.
 3. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: botanika dhe biologjia molekulare
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.
1. Zgjedhje të një asistenti të grupit të lëndëve nga sfera mësimore-shkencore: ekologjia.
Afati për zgjedhje është për kohë prej tre vjet.

INSTITUTI PËR MATEMATIKË

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: Analiza dhe analiza funksionale dhe matematika aplikative dhe modelimi matematikor.
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

INSTITUTI PËR KIMI

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve nga sfera mësimore-shkencore: kimia mësimore, nën numrin 10714 sipas Klasifikimit të sferave, fushave dhe degëve shkencore të hulumtimit, të harmonizuar sipas standardeve të OECD dhe UNESCO.
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.
2. Zgjedhje të një profesori titullar me korrespondencë të grupit të lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: kimia organike dhe biokimia
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.
3. Zgjedhje të një docenti titullar të grupit të lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: kimia organike dhe biokimia.
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/16, 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 274/2013 tekst i pastruar) si dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.
Procedura pas konkursit mund të zgjatë më së shumti gjashtë muaj.
Në Arkivin e Fakultetit kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, dokumentet e nevojshme për shkallën e arsimit (një ekzemplar origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter), vërtetim për njohje të gjuhës së huaj (në katër kopje), biografi të shkurtër (në katër kopje), formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhjen në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe titujt mësimor-profesional (merret në fakultet), certifikatë të shtetësisë (në katër kopje) dhe deklaratë për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës.
Vlera financiare e roqës bazë mësimdhënësit është 31.050,00 denarë, ndërsa për bashkëpunëtorin është 22.425,00 denarë në shumë neto. Rroga bazë mund të jetë e ndryshueshme.
Orari i punës është i vërtetuar në pajtim me kalendarin dhe orarin studentor të orëve të Fakultetit.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes.

Për informata të tjera në lidhje me Konkursin kandidatët mund të drejtohen në Sekretariatën e Fakultetit matematiko-natyror në Shkup.
Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit Matematiko-Natyror në Shkup, rr "Arhimedova" nr. 3, 1000 Shkup.

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" - SHKUP
FAKULTETI MATEMATIKO-NATYROR - SHKUP



NDIHMUI REFUGJATËT, SULMOHET ME THIKË KRYEBASHKIAKU GJERMAN

Dorasi i dyshuar, i cili sipas Lashetit u arrestua, kishte bërë vërejtje të caktuara për politikën e refugjatëve. Kjo të çon në përfundimin, që ekziston një motiv politik. Altena u bë e njohur në të gjithë Gjermaninë, sepse pranon më shumë refugjatë, se sa është e detyruar të pranojë në bazë të kriterit të shpërndarjes

Kryetari i bashkisë së qytetit të Rinit Verior në Gjermani, Vestfalisë Altena është sulmuar me thikë në një dyqan që shet Dönnner. Andreas Hollstein u dërgua me një ambulancë menjëherë në spital, por ishte në gjendje të dilte po në mbrëmje nga spitali, bëjnë të ditur mediat lokale. "Unë pata pranë njerëz që u angazhuan dhe jam i gëzuar që jam ende gjallë", i tha Hollstein pas sulmit portallit të lajmeve "Lokalstimme". Kryeministri i Landit të Rinit Verior-Vestfalisë, Armin Laschet deklaroi se autoritetet e sigurisë besojnë se motivi për sulmin ishte politik. Dorasi i dyshuar, i cili sipas Lashetit u arrestua, kishte bërë vërejtje të caktuara për politikën e refugjatëve. Kjo të çon në përfundimin, që ekziston një motiv politik. Altena u



"Unë pata pranë njerëz që u angazhuan dhe jam i gëzuar që jam ende gjallë", i tha Hollstein pas sulmit portallit të lajmeve "Lokalstimme"

bë e njohur në të gjithë Gjermaninë, sepse pranon më shumë refugjatë, se sa është e detyruar të pranojë në bazë të kriterit të shpërndarjes. Edhe një burrë, që u angazhua ta ndihmojë Hollstein-in u plagos lehtë. Sipas një raporti të "Westdeutsche Allgemeine Zeitung" sulmuesi me sa duket ishte i alkoolizuar. Para sulmit dorasi raportohet se e pyeti Hollstein-in: "Ju jeni kryetari i bashkisë?" Lascheti, i cili në momentin e atentatit po merrte pjesë në dorëzimin e Çmimit Shtetëror të Landit Rini Verior-Vestfali shkrimtarit Navid Kermani, shprehu tronditjen: "Mbrëmja e sotme ishte dëshpëruese". Gjatë dhënies së çmimit Kermani, ai i pati treguar "se si së bashku patën vizituar kryetarin e bashkisë së Altena-s, Andreas Hollstein - sepse Navid Ker-

mani iu duk shumë impresionuese, që një kryetar bashkie tha, jam i gatshëm të pranoj më shumë refugjatë", tha kryeministri. Pak më vonë, Kermani falenderoi në fjalën e tij politikanë si Henriette Reker dhe Wolfgang Schäuble, të cilët me gjithë rrezikun e atentatit, e patën vazhduar punën e tyre. Në atë kohë mbërriti lajmi që ndaj kryetarit të bashkisë së Altenas që kryer një atentat. "Kjo dhunë në vendin tonë përballë atyre që i mbështesin vullnetarisht refugjatët, kundër kryetarëve të bashkive, që kujdesen për të mirën e qytetit të tyre, është për t'u përcmuar", tha Laschet. "E qartë është: në Landin e Rinit Verior-Vestfalisë nuk ka vend për urrejtje dhe dhunë. Shumëllojshmëria është karakteristikë e landit tonë".



56 vite shofer, por pa patentë!

Aksidentet e vogla të trafikut në udhëkryqet frekuentuese urbane thuajse janë përditshmëri për ekipet e policisë së trafikut në Gjermani. Një aksident i tillë të premtën, në qytetin verilindor gjerman Neheim, ka tronditur policinë. Pas ndeshjes së dy automjeteve në qendër të qytetit policia doli në terren, ndërsa aksidentin pa të lënduar dhe me dëme materiale e shkaktuan një grua 34 vjeçare dhe një burrë 74 vjeçar. Vozitësi tashmë 56 vite ka përdorur automjet në Gjermani, ndërsa asnjëherë nuk ka dhënë provimin e patentë shoferit dhe nuk ka pasur leje për vozitje. Policia sot njoftoi se vozitësi tha se ka dhënë kërkesën për dhënie e provimit për patentë shofer para shkuarjes në ushtri para gjashtë dekadave. Orët e trajnimit nuk i vazhdoi pas kryerjes së afatit ushtarak.

Edhe Netanyahu kërkon të falet ushtari i dënuar për vrasjen e palestinezit

Kryeministri izraelit Netanyahu ka nënshkruar peticionin që i bën thirrje presidentit Rivlin që të falë ushtarin izraelit të dënuar për vrasjen e një të riu të paarmatosur palestinez vitin e kaluar



Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka nënshkruar peticionin që i bën thirrje presidentit Reuven Rivlin që të falë ushtarin izraelit të dënuar për vrasjen e një të riu të paarmatosur palestinez vitin e kaluar, njoftuan mediat izraelite. Sipas të përditshmes izraelite "The Jerusalem Post", Netanyahu shtoi emrin e tij në peticionin, tashmë të nënshkruar nga dhjetëra deputetë izraelitë, duke i kërkuar Rivlinin të rishqyrtojë vendimin e

mëparshëm për të mos falur ushtarin e dënuar Elor Azaria. Megjithatë, në një deklaratë të së martës, zyra e Rivlin pohoi se letra e peticionit ende nuk është dorëzuar zyrtarisht. "Është praktikë e zakonshme të presësh gjashtë muaj pas një kërkesë faljeje të mëparshme përpara se të lëshohet një e re", thuhet nga Zyra e Rivlin duke shtuar se "përveç nëse kanë ndodhur ndryshime të mëdha

lidhur me rastin". Dy javë më parë, Rivlin hodhi poshtë kërkesën e ndarë për të falur Azarian. Në muajin gusht, ushtari i dënuar filloi të vuante dënimin prej 18 muajsh burg në një burg ushtarak izraelit për vrasjen e Abdel-Fattah al-Sharif në mars të vitit të kaluar në qytetin e pushtuar Hebron të Bregut Perëndimor. Azaria fillimisht u dënua me 18 muaj burg për vrasjen e Al-Sharifit, dënim i de-



Azaria u bë objekt i një hetimi pasi një aktivist i grupit të të drejtave të Izraelit, B'Tselem, e kapi atë në një video duke vrarë me armë zjarri Al-Sharifin, të paarmatosur dhe të plagosur në kokë



noncuar nga shumë kritikë si shumë i lehtë. Shumë nga të djathtët e Izraelit, megjithatë, thanë që Azaria nuk do të duhej të ishte dënuar në radhë të parë. Në shtator, shefi i shtabit të ushtrisë izraelite, Gadi Eizenkot, zvogëloi dënimin e Azaria-s në vetëm 14 muaj. Azaria u bë objekt i një hetimi pasi një aktivist i grupit të të drejtave të Izraelit, B'Tselem, e kapi atë në një video duke vrarë me armë zjarri Al-Sharifin, të paarmatosur dhe të plagosur në kokë.

Për një vit, 72 sulme mbi xhamitë në Holandë

Numri i sulmeve në Holandë që për objektiv kanë xhamitë shënojnë rritje, flasin të dhënat e një raporti të publikuar nga Universiteti Sabahattin Zaim nga Stambolli. Në raportin e titulluar "Të Drejtat e Njeriut në Holandë", theksohet se gjatë vitit 2016 janë regjistruar 72 sulme mbi xhamitë në Holandë, që shënon rritje nga gjithsej 28 sa ishin regjistruar një vit më herët. Racizmi dhe Islamofobia vazhdojnë të paraqesin një çështje shumë të rëndësishme në fushën e të drejtave të njeriut në Holandë, thuhet mes tjerash në raport. Në të njëjtin raport nënvizohet se një studim i kryer në vitin 2017, flet se emigrantët në Holandë nuk ndihen të sigurt, ndërsa grupet etnike të cilat janë shprehur në atë mënyrë janë surinamezët dhe turqit. Sipas raportit, në Holandë ka gjithsej 475 xhami.

FJALIMI ORIGINAL I ISMAIL QEMALIT
MË 28 NËNTOR, 1912

RROFTË FLAMURI! RROFTË SHQIPËRIJA!



Oh! Sa të lumtur që e ndiej vehten sot, që shoh, këtu në Vlorë, kaqë burra Shqipëtarë të mbledhur tok, tuke pritur me kureshti e padurim përfundimin e kësaj mbledhjeje historike, për fatin e Atdheut tonë të dashur. Plot me gaz e me lot ndër sy, nga mallëngjimi, pra, po dal këtu para jush që t'ju gëzoj me sihariqin e madh, se sot, edhe këtë minutë, Kongresi çpalli mëvehtësinë e Shqipërisë, tuke lajmëruar gjithë botën mbarë për këtë punë e duke më ngarkuar mua kryesin' e qeveris së përkohshme të Shqipërisë së lirë.

Porsi ëndër më duket ky ndryshim i madh i vendit t'onë, që hoqi e voi të zezat e të lirit pesëqind vjet me radhë ndënë sundimin turk, por që tani në kohët e fundit, ishte gati të jepte shpirtin përgjithënjë, të shuhej e të çfarosej krejtësisht nga faqia e dheut, këjo Shqipëri, që, dikur, shkëlqente nga trimëria e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri, që kur i kërcënohej rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t'egër që ka pas Turqija.

Mirëpo, desh Zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoq të Shqipëtarëve, sot e tutje të marrin fund mjerimet dhe vuajtjet e Atdheut t'onë, sepse, këtu e kështu, jemi të LIRË të PAVARUR dhe MËVEHTE, prandaj: qeshni e gëzoni!

Për t'ia arrijtur kësaj dite të bardhë e të madhe, na ka ndihmuar gjaku i dëshmorëve dhe puna e vlefshme e patriotëve t'anë dhe e të gjithë shokëve që muarrnë pjesë në këtë mbledhje dhe e të gjithë juve, që tani po ju gufon zemëra nga gazi i madh që ndieni; mirëpo mbledhja si më

plak që jam, m'a ngarkoi mua Ngritjen e shënjtë të shënjës t'onë Kombëtare, të flamurit t'onë të ëndërruar e të dashur (nxjerr Flamurin, të cilin e ka të vendosur në një shtizë hekuri, natyrisht të vogël, dhe të pshehur nën pallto dhe passi e mba një sekondë në dorë e ngul në shtyllat e ballkonit. Shqiptarët, posa e shohin Flamurin thërrasin me gëzim e me zë të lartë: Rroftë Flamuri, Rroftë Shqipëria e Lirë).

Ja, pra, ky është Flamuri Ynë i kuq e me shqiponjën dykrenare të zezë në mest.

Dhe tani, të gjithë bashkë, si

një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për t'a mburuar, për t'a përparuar e për t'a qytetëruar si i ka hije Atdhenë t'onë të Lirë.

Tuke përfunduar, s'më mbetet gjë, veçse t'i drejtoj një lutje Zotit të Madh, që, bashkë me bekimet e Tij që i lipij të na japë për të qenë të denjë të kësaj dite, të pranojë që këtej e tutje të jem unë dëshmori më i parë i Atdheut, ashtu siç pata nderin dhe fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valvitet i Lirë.

Flamuri i ynë, n'atdhenë t'onë të lirë.

Rroftë Flamuri!
Rroftë Shqipëria!

TELEGRAMI I SHKODRANËVE DREJTUAR PRINC VIDIT

SHKODRA KËRKON TË BËHET KRYEQYTET!

Gazeta franceze, "Le Temps", ka botuar, të dielën e 8 marsit 1914, në faqen 2, telegramin e shkodranëve drejtuar Princ Vidit me qëllim që qyteti i tyre (djep i historisë, kulturës dhe traditës shqiptare) të bëhej kryeqendra e Shqipërisë. Çfarë përmban më konkretisht ky telegram? Si e kanë justifikuar këtë kërkesë shkodranët? Kush e ka firmosur?

Ne kemi marrë nga Shkodra telegramin më poshtë:

Sot, të bashkuar në mënyrë spontane në qytetin tonë prej 30 000 banorësh të Shkodrës, të zonave dhe maleve përreth dhe duke pasur parasysh vetëm interesin dhe të mirën e kombit dhe të shtetit shqiptar, zhvilluam një takim për të kërkuar që Shkodra të bëhet kryeqytet i Shqipërisë. Pasi dëgjua fjalimet e oratorëve të ndryshëm, ne kemi vendosur ndryshim e plotë të Princ Vidit si mbret të Shqipërisë, i cili sapo është zgjedhur nga Evropa dhe kurorëzuar mbret nga populli shqiptar.



Ne i urojmë mirëseardhjen mbretit tonë në tokën shqiptare, i ofrojmë atij shërbimet e shqiptarëve besnikë dhe të vërtetshëm, i betohemi për nënshtrim, bindje dhe besnikëri. Në emër të banorëve të Shkodrës, të zonave malore të Malsisë, Mirditës, Dukagjinit, të një pjese të Kosovës, të zonave përreth Shkodrës e deri në dalje të detit, që përbëjnë pjesën më të rëndësishme të Shqipërisë, kërkojmë që Shkodra të bëhet kryeqytet i shte-

tit tonë për arsyet në vijim:

Qyteti, i famshëm dhe historik kujtimesh dhe luftëtarësh të vjetër shqiptarë, është më i forti, më i madhi, më i bukuri dhe më i shëndetshmi nga të gjitha qytetet e Shqipërisë aktuale. Shkodra është qyteti i vetëm në Shqipëri që ka ndërtesat më të nevojshme për sovranin, për zyrat e shtetit, për ushtrinë kombëtare, për ministrat dhe konsujt e huaj, për ministrinë e qeverisë, etj. Në mënyrë spontane,

ajo vë këto ndërtesa në dispozicionin e shtetit, pa qenë nevoja që ky i fundit të shpenzojë miliona për ndërtimin e godinave të cilat janë të domosdoshme. Shkodra, me të cilën janë të lidhura të gjitha malet e Shqipërisë luftëtare, është strategjikisht qyteti më i madh i Shqipërisë, rrethimi i fundit i saj e ka dëshmuar si qytetin më të famshëm në botë për forcën dhe rezistencën luftarake, sepse ajo rezistoi më shumë se çdo qytet tjetër dhe nuk ra me forcën e armëve në duart e armikut.

Shkodra, kryeqytet i Shqipërisë, e fortifikuar ashtu siç duhet, ushtarakisht dhe strategjikisht, do të jetë, me liqenin, lumenjtë dhe kodrat që e rrethojnë, aq e fortë sa asnjë ushtri e madhe nuk do të mund ta pushtojë, qoftë edhe pas shtatë vjetësh rrethim, ashtu si nuk mundën ta merrnin, pas shtatë muajsh, ushtritë e dy vendeve ballkanike. E gjithë Shqipëria është sot dhe do të jetë gjithmonë katër herë më e lehtë për t'u pushtuar, nga kushdo, se qyteti i Shkodrës, i

mbështetur dhe i përkrahur nga besnikëria e të gjithë shqiptarëve.

Shkodra, nëse nuk bëhet kryeqytet, do të jetë në rrezik për t'u shpëputur nga atdheu. Me qytetin e Shkodrës, do të shpëputen të gjitha zonat përreth, të cilat me të formojnë pjesën kryesore të Shqipërisë. Natyrisht, ndarja dhe shkatërrimi i të gjithë atdheut tonë është në dyshim. Kryesisht, për këtë arsye, Shkodra dhe banorët e saj të bashkuar u bëjnë thirrje qyteteve të Elbasanit, Korçës, Gjirokastrës, të gjithave krahinave shqiptare dhe të gjithë shqiptarëve që e duan atdheun e tyre që të jenë mbështetës të kësaj kërkesë. Prandaj, ajo i lutet Madhërisë së Tij Mbretit të shqiptarëve dhe të kombit shqiptar që të marrë parasysh në mënyrë favorshme këtë kërkesë. Rroftë mbreti i shqiptarëve! Rroftë Shqipëria e pavarur! Rroftë Shkodra kryeqytet! Ky telegram është nënshkruar (firmosur) nga komiteti organizues, i cili përfshin Kryepeshkopin, Kryetarin e Komunës dhe parësinë e Shkodrës.



Interesimi i të huajve për territoret e Perandorisë Osmane në Ballkan nxiti interesimin edhe për Shqipërinë

SHQIPËRIA E VITIT 1898 NË SYTË E NJË SKOCEZI

Salih MEHMETI

Përshkrimet në superlativ për Shqipërinë dhe shqiptarët janë të pafundme. Interesimi i të huajve për territoret e Perandorisë Osmane në Ballkan nxiti interesimin edhe për Shqipërinë. Projektori i njohjes ra mbi shqiptarët si popull, veçanësinë e tyre kulturore, tokat e tyre, karakterin individual e kolektiv.

Po sjellim një përshkrim të Hugh Callan të botuar në «The Scottish Geographical Magazine» në vitin 1898: «Shqipëria duket që ka qenë prapë ajo që është sot, një shtrojerë e një race njerëzish të rreptë e të patrembur. Është një

truall malesh, një tokë e zakoneve të qëmoçme, veshjeve të vjetra, hakmarrjeve të vjetra; një visore e fiseve, secili i hakërryer kundër njëri tjetrit; një tokë e vetjakizmit, aty ku instinkti social vritet nga e drejta dhe mujsharia e secilit për të vepruar si t'ia dojë kokrra e qejfit. Pozicioni i saj është i tillë që kjo racë mund ta mbrojë vetën prej çdo pushtuesi. Në lindje kufizohet prej Maqedonisë dhe Thesalisë nga një vijë e maleve (Sharr dhe Pind) dhe liqeneve të mëdha (Ohër dhe Prespë); në jug nga malësitë e Greqisë dhe gjirit të Artës; në perëndim nga Adriatiku i rrëmbyer; një vijë e gjatë prej shkëmbinjve të pakalueshëm (Himara

ose Akrokeraunia), dhe brigjeve të gjata me xhepa kënetorë (nga Vlora deri te gjiri i Drinit), në veri nga Mali i Zi dhe Novi Pazari.

[...] Nëse pellazgët janë stërgjyshërit e vërtetë të shqiptarëve ose jo, të paktën duket e sigurtë që ata kanë mbetur të pandryshuar për mijëra vjet, saqë shkërbejnë me përshkrimet e vjetra greke për jetën. Sistemi i mikpritjes, grupimi i tokave në rrethe që udhëhiqen nga prijës trashëgimtarë, veshja e tyre – fustanella, tunika, sandalet, tirqit, guna e leshtë e barinjve, qentë e mëdhenj që ruajnë dhentë, që të gjitha janë sugjестive për një prejardhje të vjetër». (konika.al)

KËNGA MAGJIKE PAS SË CILËS FSHIHET NJË HISTORI E TRISHTË

Dokument i kësaj kënge për herë të parë gjendet në dorëshkrimin e Kieutit botim i vitit 1708, më pas këtë material do ta ribotonte në librin e tij filologu arbëresh Dhimitër Kamarda (1821-1882)

Andreas DUSHI

Të gjithë e kemi dëgjuar këngën «Moj e bukura More», një ndër lirikat më të bukura të shkruara ndonjëherë për atdheun. Por pas këtyre vargjeve fshihet një histori e rrallë, e trishtë dhe e shprehur aq bukur sa rrallë herë mund të haset në këngët e asaj kohe.

Në shekullin XVI, një pjesë e banorëve të trojeve arbërore u detyruan të largoheshin nga aty drejt bregut tjetër të Adriatikut duke kërkuar atje paqen dhe lumturinë që në trojet e tyre pushtuesi turk po ia mohonte. Ata vinin nga Veriu dhe Jugu, nga Lindja dhe Perëndimi, nga fushat e malet e atyre trojeve me një bukuri të rrallë dhe shumë të lakmueshme dhe, veç të tjerash, bashkoheshin edhe në dhimbjen për lënien e atdheut.

Vuajtjet e përjetuara gjatë kësaj vale emigrimi përshkruhen më së miri në kronikat e kohës. Papa Piu II i shkruante Dukës së Burgonjës, Filipit: «Nuk mund t'i shohë njeriu pa derdhur lot këta re-

fugjatë nëpër limanet e Italisë të uritur e të zhveshur, të shpërngulur nga vatrat e tyre që rrinë anës detit e ngrënë në qiell duart. Qajnë e vajtojnë në një gjuhë që s'ua marrim dot vesh.»

Në këtë dhimbje, duke kaluar ditët në vendet larg atdheut, nga shpirti i arbërve që u larguan nga Moreja, lindi një ndër elegjitë më të bukura, lirikat më të ndjeshme të shprehura në disa vargje të magjishme. «Moj e bukura More» mbetet edhe sot si lajtmotivi i dhimbjes shqiptare ndër shekuj, kur ata, të detyruar, i kthen atdheut shpinën, por në të lanë zemrën.

Dokument i kësaj kënge për herë të parë gjendet në dorëshkrimin e Kieutit



botim i vitit 1708, më pas këtë material do ta ribotonte në librin e tij filologu arbëresh Dhimitër Kamarda (1821-1882), në vitin 1866. Në këtë lëndë është publikuar teksti i kësaj kënge i shkruar në shqip, por me alfabet grek:

*Moj e bukura More,
si të lash e më s'të pash!
Si të lash, si të lash,
siç të gjeta ngë të lash!
Atje kam unë zotin At',
atje kam unë zonjën Mëmë,
atje kam dhe tim vëlla,
gjithë mbuluar,
të gjithë mbuluar,
të gjithë mbuluar nën dhe!
Ah e bukura More!*

Liberali britanik që ravijëzoi kufijtë e Shqipërisë së sotme

Jashtë shtetit shqiptar u lanë hapësira të konsiderueshme shqiptare si Kosova, Sanxhaku i Novi Pazarit, lugina e Vardarit si dhe tërë krahina e Çamërisë, bashkë me pjesë të konsiderueshme të Pindit

Sir Edward Grey, një sqimë e vërtetë britanike, siç imponon timbri i të shqiptuarit të këtij emri. Ai ishte sekretari i Shtetit për Çështje të Jashtme të Britanisë së Madhe në momentin dramatik kur u vendos për të ardhmen e Shqipërisë. Por, cili ishte roli i tij në konfigurimin e Ballkanit modern, krijimin e kufijve të rinj dhe të balancave përjetësisht të brishta

në territoret e sapo çliuara nga pushtimi i gjatë osman? Grey ishte një nga zërat kryesorë që ngulmuan që çështja shqiptare të mbarëstrohej në tri drejtime në Konferencën e Paqes në Londër: statusi ndërkombëtar i Shqipërisë; organizimi i shtetit të ri shqiptar; dhe ravijëzimi i kufijve të pranueshëm ndërkombëtarisht.

Jashtë shtetit shqiptar u lanë hapësira të konsiderueshme shqiptare si Kosova, Sanxhaku i Novi Pazarit, lugina e Vardarit si dhe tërë krahina e Çamërisë, bashkë me pjesë të konsiderueshme të Pindit. Hilja në tërheqjen e këtyre kufijve ishte aq e evidente, saqë në një fjalim të mbajtur në parlamentin britanik, Grey pranonte hapur se synimi kryesor për kufijtë ishte kënaqja e Fuqive të Mëdha, dhe se shumë kritikizëm mund të ngritej nga secili që e njihte Shqipërinë dhe e shikonte atë nga pikëpamja e atij vendi. Sidoqoftë, figura e diplomatit britanik mund të shikohet edhe nga këndvështrime të tjera. Qysh në nëntor të vitit 1912, në një letër dërguar ambasadorit britanik në Romë Rennell Rodd, ai theksonte se çështja kryesore për Fuqitë e Mëdha ishte nëse aleatët ballkanikë duhet të lejoheshin t'i mbanin territoret që i kishin marrë pas fitores mbi turqit, apo ata duhej të kufizoheshin në madhësinë e territoreve të cilat mund t'i mbanin. Në këtë raport del që Grey, nën trysinë e opinionit publik që favorizonte aleatët ballkanikë, nisi të ndryshonte mendje sa i përket nevojës së njohjes së rikompozimit territorial të Ballkanit. Gjithsesi, qëndrimi negativ i Vjenës karshi kërkesave territoriale, sidomos të Beogradit, bën që Grey të bëhej më i përkorë dhe të hiqte dorë nga simpatia për një Serbi të zgjeruar. Përkrahja e tij fillestare që Serbia të kishte dalje në Adriatik do të fillonte të zbehej sërisht prej insistencës austriake.

Kufiri lindor i shtetit shqiptar ishte bërë mjaft i debatueshëm, sidomos e ardhmja e Gjakovës dhe Dibrës. Në një mesazh dërguar Beogradit, që mban datën 12 shkurt 1913, sekretari britanik thoshte se publiku serb po harronte që Serbia tashmë kishte marrë pika të rëndësishme: Sanxhakun e Novi Pazarit, shumicën e Maqedonisë, Prizrenin dhe Pejë. Ai i tërhiqte vërejtjen qeverisë serbe se Dibra dhe Gjakova nuk mund të mbaheshin ndryshe, përpos me forcë, dhe se Londra nuk do të shkente në luftë për shkak të këtyre qyteteve. (konika.al)



• Sir Edward Grey



Republic of Macedonia
Ministry of finance

PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE TË MSIP
(IBRD 8158MK, IBRD 8561MK DHE TF018812)
NUMRI IDENTIFIKUES I PROJEKTIT : R096481 и R154464

SHPALLJE PËR ANGAZHIME PUNUESE NË KOHË TË CAKTURA TË PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIM TË SHËRBIMEVE KOMUNALE - MSIP

Qeveria e Republikës së Maqedonisë fitoi hua nga Banka ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim - Banka botërore dhe grant të financuar mjete nga ndihma paraqasëse të Unionit Evropian për implementimin e Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale. Projekti ka për qëllim që ti përmirësojë performancat e ekonomive urbane dhe cilësinë e udhëheqjes në nivel komunal nëpërmjet sigurimit të përkrahjes financiare dhe këshilldhënese të më shumë komunave të selektuara në pjesën e planifikimit dhe udhëheqjes komunale si dhe sigurimin e shërbimeve më cilësore komunale.

Me qëllim të implementimit të suksesshëm të Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale, Ministria e financave ka nevojë për angazhimin e konsulentëve lokal individual edhe atë në pozitat në vijim:

- Koordinator kryesor -1 (një), konsulent individual,
- Inxhinier ndërtimtarie - 2 (dy), konsulent individual;
- Inxhinier më të ri ndërtimtarie - 2 (dy), konsulent individual;
- Ekonomist 1 (një), konsulent individual;
- Konsulent për mjedis jetësor - 1 (një), konsulent individual;
- Asistent për furnizime - 1 (një), konsulent individual.

1. Koordinator kryesor -1 (një), konsulent individual

Kompetencat themelore:

Udhëheq me aktivitetet e përditshme të MSIP; E përfaqëson MSIP në marrëdhëniet me institucionet qeveritare, njësite e vetererisjes lokale, institucionet ndërkombëtare financiare dhe donatorë tjerë multilaterale dhe bilaterale; Përgatit biznes plan afatgjat për MSIP si dhe të gjitha ndryshimet e planit; Koordinim të amandamenteve dhe ndryshimet e Doracakut operativ të Projektit dhe dorëzimin e tyre deri te Komiteti koordinativ për aprovim. Propozon dhe organizon mbledhje të Komitetit koordinativ; Mer pjesë në të gjitha mbledhjet e Komitetit koordinativ pa të drejtë vote; Përgatit dokumentacionin për dorëzim në mbledhjet e Komitetit koordinativ dhe i përgatit dhe publikon procesverbalet nga ata mbledhje; Siguron koordinim të ngushtë ndërmjet ndihmës teknike dhe aktiviteve investuese të financuara në kuadër të MSIP. Përgatit rekomandime për Komitetin koordinativ (Ministri i financave) për miratim të financimit nga ana e MSIP për investime konkrete gjegjësisht projekte të ndihmës teknike: Përcjellë implementimin e tërësisht të projektit; Përpilon raporte gjysmëvjetore dhe vjetore për përparim të cilat dorëzohen deri tek Komiteti koordinativ, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Banka Botërore ose donatorë të tjerë, si dhe raporte të tjera periodike gjegjësisht të jashtëzakonshme dhe/ose dokumentacion në lidhje me aktivitetet e MSIP ose punën teknike ose financiare, të cilat mund të kërkohen nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Banka botërore ose ndonjë donator tjetër; Vendosë sisteme për përcjellje dhe evaluim të suksesshmërisë së programeve investuese dhe programeve për ndihmë teknike, dhe mbikëqyrje të realizimit të tillë dhe evaluim të bazës së vazhdueshme; Mbikëqyrje të funksionimit të sistemit për menaxhim financiar, sistemit të vendosur për kontroll të brendshme dhe sistemit financiar; Kontroll të udhëheqjes së kontabilitetit, përgatitje dhe parashtrim të raporteve financiare në pajtim me Ligjin për kontabilitet të buxhetit dhe shfrytëzuesve buxhetor të Republikës së Maqedonisë.

Kualifikimet e nevojshme për Koordinatorin kryesor:

- Arsimit sipëror nga sfera e ekonomisë, administratës afariste, administratës publike ose inxhinierisë së ndërtimtarisë;
- Së paku 10 vjet përvojë pune në institucione qeveritare dhe/ose të tjera të sektorit publik, ose organizata ndërkombëtare, ose sektorit privat ndërkombëtar, ose në sektorin joqeveritar;
- Së paku tre vjet përvojë në sferën e menaxhimit me projektet;
- Njohje të mirë të institucioneve shtetërore të Maqedonisë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal;
- Përvojë paraprake në realizimin e projekteve të Bankës botërore do të konsiderohet si përparësi;
- Aftësi të mira komunikimi dhe sociale;
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës maqedonase dhe angleze.

2. Inxhinier i ndërtimtarisë - 2 (dy), konsulent individual

Kompetencat themelore:

Kompetencat themelore të inxhinierit të ndërtimtarisë janë: ndihmë të komunave potenciale pjesëmarrëse në Projektin rreth identifikimit të projekteve të mundshme investuese, këshillim të komunave rreth zgjidhjeve të mundshme teknike, verifikim të harmonizimit të projekteve investuese me dispozitat ekzistuese ligjore të Republikës së Maqedonisë dhe rregullave dhe politikave të Bankës Botërore, përpilim të dokumentacionit projektues dhe ndihmë të nëpunësit për furnizime gjatë përpilimit të dokumentacionit tenderues, ndihmë gjatë evaluimit të ofertave tenderuese për furnizim të mallrave dhe punëve ndërtimore, kontroll të realizimit të punëve ndërtimore nga ana e komunave, mbikëqyrje të punës së mbikëqyrësit si dhe punë të tjera në kompetencë të inxhinierit të ndërtimtarisë të definuara me Rregulloren për menaxhim me Projektin për përmirësim të shërbimeve komunale.

Kualifikimet e nevojshme për Inxhinierin e ndërtimtarisë:

- Diplomë universitare në sferën e ndërtimtarisë ose arkitekturës, shkallë magjistrature do të konsiderohet si përparësi;
- Kandidatët me diplomë nga sfera e ndërtimtarisë, të cilët në pajtim me Ligjin për ndërtim posedojnë autorizim për përpilim të dokumentacionit projektues për ndërtim, autorizim për inxhinier mbikëqyrës për ndërtime si dhe

autorizim për realizim të ndërtimit do të kenë përparësi gjatë përzgjedhjes.

- Minimum 5 vjet përvojë relevante profesionale në përpilimin dhe menaxhimin me projekte infrastrukturore, punë ndërtimore, duke përfshirë projekte themelore dhe mbikëqyrje; Përvoja në punën me projektet të financuara nga Banka botërore dhe njohje të procedurave për lajmërim dhe furnizim të Bankës do të jetë përparësi;
- Njohje të mirë të dispozitave nacionale të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, shërbimet komunale dhe furnizimet përmes agjencive qeveritare;
- Aftësi të mira komunikimi;
- Aftësi shumë të mira kompjuterike (Word, Excel, Access);
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës maqedonase dhe angleze.

3. Inxhinier i ri i ndërtimtarisë - 2 (dy), konsulent individual

Kompetencat themelore:

Kompetencat themelore të inxhinierit të ndërtimtarisë janë: ndihmë të komunave potenciale pjesëmarrëse në Projektin rreth identifikimit të projekteve të mundshme investuese, këshillim të komunave rreth zgjidhjeve të mundshme teknike, verifikim të harmonizimit të projekteve investuese me dispozitat ekzistuese ligjore të Republikës së Maqedonisë dhe rregullave dhe politikave të Bankës Botërore, përpilim të dokumentacionit projektues dhe ndihmë të nëpunësit për furnizime gjatë përpilimit të dokumentacionit tenderues, ndihmë gjatë evaluimit të ofertave tenderuese për furnizim të mallrave dhe punëve ndërtimore, kontroll të realizimit të punëve ndërtimore nga ana e komunave, mbikëqyrje të punës së mbikëqyrësit si dhe punë të tjera në kompetencë të inxhinierit të ndërtimtarisë të definuara me Rregulloren për menaxhim me Projektin për përmirësim të shërbimeve komunale.

Kualifikimet e nevojshme për Inxhinierin e ri të ndërtimtarisë:

- Diplomë universitare në sferën e ndërtimtarisë ose arkitekturës, shkallë magjistrature do të konsiderohet si përparësi;
- Kandidatët me diplomë nga sfera e ndërtimtarisë, të cilët në pajtim me Ligjin për ndërtim posedojnë autorizim për përpilim të dokumentacionit projektues për ndërtim, autorizim për inxhinier mbikëqyrës për ndërtime si dhe autorizim për realizim të ndërtimit do të kenë përparësi gjatë përzgjedhjes.
- Minimum 3 vjet përvojë relevante profesionale në përpilimin dhe menaxhimin me projekte infrastrukturore, punë ndërtimore, duke përfshirë dizajn të detajuar dhe mbikëqyrje; Përvoja në punën me projektet të financuara nga Banka botërore dhe njohje të procedurave për lajmërim dhe furnizim të Bankës do të jetë përparësi;
- Njohje të mirë të dispozitave nacionale të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, shërbimet komunale dhe furnizimet përmes agjencive qeveritare;
- Aftësi të mira komunikimi;
- Aftësi shumë të mira kompjuterike (Word, Excel, Access);
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës maqedonase dhe angleze.

4. Ekonomist -1 (një) konsulent individual

Kompetencat themelore

Zhvillim dhe pasqyrim të dokumenteve për vlerësim të projekteve për komunat e theksuara të cilat i kanë faktorët në vijim si qasje strukturore: Përshkrim të nën-projektit; Ndikim social; studim sociologjik (variabla të analizuar: llojllojshmëri sociale dhe gjini, institucione, rregulla dhe sjellje, pjesëmarrës, pjesëmarrje, rreziqe sociale) dhe çështje për shpërngulje; Zgjidhje teknike: përshkrim, analizë, evaluim dhe ndryshime potenciale; Analizë financiare: shpenzimet për projektin, pagesë të kredisë, kontrollim të llogarive të ndërmarrjeve shtetërore komunale, analizë të fizibilitetit financiar të projektit; Analizë të shpenzimeve: identifikim dhe vlerësim të shpenzimeve dhe dobive relevante, supozime, analizë të fizibilitetit ekonomik të projektit, analizë të ndjeshmërisë, analizë të ekonomizimit (në rast të skenarëve të shumëfishtë dhe kur benificionet nuk mund të shprehen në vlerësim monetare); Analiza e rezikut; Zgjedhja e skenarit; Rekomandimet; Ndiemon në definimin e indikatorëve relevant dhe matës për përcjelljen e nën-projektit dhe siguron mbështetje gjatë grumbullimit dhe prezantimit të tyre.

Kualifikimet e nevojshme për Ekonomistin:

- Diplomë universitare nga sfera e ekonomisë ose administratës së biznesit ose financave.
- Minimum 8 vjet përvojë relevante profesionale, e cila përfshinë 5 vjet përvojë në fusha të ngjashme (siç janë investimet, analiza financiare dhe ekonomike e investimeve etj.);
- Përvojë në zhvillimin e Dokumenteve për vlerësim të projekteve ose Studime për fizibilitet për projekte investuese;
- Ekspertizë të dëshmuar të suksesshme në 3 vitet e fundit në përgatitje, vlerësim ose vlerësim të së paku 3 projekteve për investime infrastrukturore;
- Përvojë të dëshmuar të suksesshme në bashkëpunim me institucionet qeveritare, duke përfshirë edhe vetëqeverisjen lokale (komunat) dhe institucionet financiare ndërkombëtare;
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës maqedonase dhe angleze.

5. Konsulent për mjedisin jetësor -1 (një) konsulent individual.

Kompetencat themelore

Përpilim dhe kontrollim të listave për mjedisin jetësor për nën-projektin në pajtim me vlerësimin për mjedisin jetësor dhe dokumentin kornizë; Rishikim dhe propozim përmirësime dhe/ose ndryshime në propozim-planet për zbutje të ndikimit ndaj mjedisit jetësor, të përbajtura në studimet përkatëse për fizibilitet dhe projekte themelore të nën-projekteve, në pajtim me Vlerësimin për mjedisin jetësor dhe Dokumentin kornizë; Rishikim dhe kontrollim për kompletim të planeve për monitorim të mjedisit jetësor të nën-projektit në pajtim me vlerësimin për mjedisin jetësor dhe Dokumentin kornizë; Të mbikëqyrë realizimin e Planeve për zbutje të mjedisit jetësor dhe Planeve për përcjellje të mjedisit jetësor gjatë realizimit të punëve në komuna; Përpilim të raporteve për monitorim të mjedisit jetësor, duke përfshirë raporte për përparim të projektit për secilin nën-projekt aktual, në pajtim me PAD dhe POM. Pjesëmarrje në misionet e rregullta për mbikëqyrje.

Kualifikimet e nevojshme për Konsulentin për mjedisin jetësor:

- Diplomë universitare nga sfera e ndërtimtarisë, teknologjisë, shkencave për mjedis jetësor, inxhinieri të mjedisit jetësor, shkencave natyrore, menaxhim me resurset natyrore ose sferën e ngjashme. Shkalla e magjistraturës do të jetë përparësi;
- Përvojë të përgjithshme profesionale prej së paku 5 vjet, duke përfshirë përvojën në kontrollimin e implementimit të planeve për mjedisin jetësor, vlerësim ekologjik multidisiplinues.
- Përvojë në detyra të ngjashme në Republikën e Maqedonisë;
- Aftësi të mira komunikimi;
- Aftësi shumë të mira kompjuterike (Word, Excel, Access);
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës maqedonase dhe angleze.

6. Asistent për furnizime - 1 (një) konsulent individual.

Kompetencat themelore:

Kompetencat themelore të asistentit për furnizime janë: mbështetje të specialistit për furnizime në mënyrë që të konsolidohen kërkesat për furnizim të mallrave, punëve ndërtimore, shërbimeve teknike dhe konsulente si dhe ndihmë të specialistit për furnizime në kontrollimin e pakove të dorëzuara për furnizime publike nga ana e komunave, mbështetje të specialistit për furnizime në mirëmbajtjen e sistemit efikas për përcjellje të procesit të furnizimit dhe implementimit të marrëveshjeve në emër të EIP (incizim të datave të të gjitha lejeve të rëndësishme, marrëveshjeve, shumave etj.), si dhe përgatitje të sistemit përkatës të evidencës/sistemit që të sigurohet kalim i shpejtë i informacioneve për furnizim, ndihmë të specialistit për furnizim në përpilimin e: dokumenteve për furnizim (për shembull. Ftesave për ofertë, dokumenteve standarde për ankad, qartësim dhe ndryshime eventuale, raporte për evaluim, etj), ndihmë të specialistit për furnizime në organizim dhe menaxhim me konferenca të hapjes publike të ofertave si dhe realizim të procesit të hapjes së ofertave.

Kualifikimet e nevojshme për Asistentin për furnizime:

- Arsimit sipëror përkatës;
- Minimum 5 vjet përvojë të përgjithshme profesionale dhe 2 vjet përvojë specifike/relevante në furnizim të mallrave, punëve, shërbimeve teknike dhe konsulente në lidhje me realizimin e projekteve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë (përvojë në realizimin e furnizimeve sipas rregullave të Bankës botërore paraqet përparësi);
- Njohuri në planifikimin dhe realizimin e tenderëve për mallra, punë ndërtimore, shërbimeve teknike dhe konsulente;
- Njohje të drejtimeve dhe procedurave për furnizim të Bankës Botërore si dhe të Ligjit për furnizime publike;
- Shfrytëzim aktiv të IT aplikacioneve në vijim (Word, Excel, Power Point, Outlook, web);
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës maqedonase dhe angleze.

Personat për pozitat e theksuara të konsulentëve do të zgjidhen në pajtim me edicionin "Drejtimit: Përzgjedhje dhe punsim të konsulentëve nga ana e huapranuesve të Bankës Botërore", të publikuar nga ana e Bankës Botërore në janar të vitit 2011, të reviduar në korrik të vitit 2014.

Konsulentët e interesuar ftohen që të parashtrorjnë biografitë e tyre të punës në gjuhën angleze të cilat para së gjithash duhet të përmbajnë pasqyrë e cila do të vërtetojë kualifikimin e tyre për përmbushjen e kualifikimeve të theksuara (në aplikacion patjetër duhet të theksohet pozita për të cilën aplikohet).

Interesimi i shprehur me biografi të punës, letër motivimi dhe të gjitha dokumentet relevante të bashkëngjitura, duhet të parashtrorhen në formë elektronike në format pdf ose word dokument madhësia e të cilit nuk kalon 10 MB, në adresën e shënuar më poshtë jo më vonë se (14) dhjetor të vitit 2017, deri në ora 16:30.

Ministria e financave
Dame Gruev, 12
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë
e-mail: aleksandar.najdovski@finance.gov.mk

KUPA E MAQEDONISË

NDAJ VARDARIT PËR SENSACION

Fituesi nga ky ballafaqim do të plasohet në çerekfinale, ndërsa aty do të përballlet me skuadrën e Shkëndijës, e cila ka qenë e lirë. Ndryshe, dy rivalët e mëdhenj do të ndeshen edhe të dielën në kuadër të javës së 18-të në Ligën e parë futbollistike, ku nikoqir do të jetë FC Shkupi



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 29 nëntor – Skuadra e Vardarit dhe Shkupit sot në ora 13 në stadiumin në lagjen Cjorçe Petrov do të zhvillojnë ndeshjen e parë të 1/8 së finales së Kupës së Maqedonisë. Fituesi nga ky ballafaqim do të plasohet në çerekfinale, ndërsa aty do të përballlet me skuadrën e Shkëndijës, e cila ka qenë e lirë. Ndryshe, dy rivalët e mëdhenj do të ndeshen edhe të dielën në kuadër të javës së 18-të në Ligën e parë futbollistike, ku nikoqir do të jetë FC Shkupi. Sa i përket përballjes së sotme, nga kampi bardheblu pranojnë se nuk do të jetë aspak lehtë, por me një menaxhim dhe koncentrim, besojnë se mund të befasonjë kampionët. Kështu të paktën mendon

Shqiprim Taipi, njëri prej dy futbollistëve të huazuar nga te Shkupi nga skuadra e Shkëndijës. “Po vazhdojmë të luajmë lojë të mirë edhe pse me temp të shtuar. Kemi pasur gjatë këtyre javëve ndeshje të njëpasnjëshme dhe që ishin shumë të rëndësishme për ne pasi luanim me konkurrentët kryesorë në tabelë. Por, sigurisht se skuadra jonë futet me ambicie për ta vazhduar edhe më tej rrugëtimin në Kupën e Maqedonisë. Ndeshja ndaj Vardarit nuk do të jetë aspak e lehtë, por besoj se me menaxhim të mirë të topit dhe lojë të koncentruar mund të befasonjë kampionët. Sigurisht se duhet menduar edhe për ndeshjen e të dielës, kur luajmë përsëri me Vardarin për pikë dhe kjo na bënë që të jemi

REZULTATET:

A. PANDEV – TETEKS	4-1 (2-0)
SKOPJE – RENOVA	1-2 (0-2)
POBEDA – PELISTERI	2-2 (2-5)
SHKËNDIJA (E LIRË)	

SOT, 1/8 e finales ndeshja e parë VARDARI - SHKUPI

shumë të kujdesshëm. Gëzon fakti se kemi përmirësuar edhe realizimin, ndërkohë shpresoj që ekipi të dalë me rezultat pozitiv nga ndeshja e parë”, deklaroi Taipi. Ndryshe, për duelin e parë ndaj Vardarit, Shkupi ka vetëm një mungesë dhe ai është Bunjamin Shabanin, i cili ka filluar të punojë me ekipin, por ende nuk është i gatshëm për të luajtur ndeshje.



Shqiprim Taipi

Ndeshja ndaj Vardarit nuk do të jetë aspak e lehtë, por besoj se me menaxhim të mirë të topit dhe lojë të koncentruar mund të befasonjë kampionët. Sigurisht se duhet menduar edhe për ndeshjen e të dielës, kur luajmë përsëri me Vardarin për pikë dhe kjo na bënë që të jemi shumë të kujdesshëm

Ndërkohë, dje u zhvilluan tre ndeshjet kthyes të çerekfinales së Kupës. Skuadra e Renovës mundi “Skopjen” me 1-2, me çka futbollistët e skuadrës tetovare janë skuadra e cila u plasuan në gjysmëfinale. Ata arritën që në stadiumin “Hekuran” të mbrojnë epërsinë nga ndeshja e parë prej 2-0 dhe me fitore në momentet e fundit të ndeshjes të inkuadrohen në katërshen më të mirë në këtë kompeticion të garave. “Akademia Pandev” gjithashtu siguroi vend në gjysmëfinale. Edhe në përballjen e dytë ata mundën anëtarin e Ligës së Dytë, Teteks me 4-1 dhe me rezultatin e përgjithshëm 6-1 u plasuan në katërshen më të mirë. Derisa, në përballjen e tretë, Pelisteri falë triumfit me 5-2 në ndeshjen e parë, arriti të plasohet në gjysmëfinale. Ndryshe, përballja e dytë mes këtyre dy skuadrave përfundoi baras 2-2 kështu që Pelisteri është në rrugë të mirë që të mbrojë titullin e këtij trofeu.

Shaqiri qëndron te Stok Siti

Xherdan Shaqiri do të vazhdojë të qëndrojë te skuadra e Stok Siti. Lajmi konfirmohet nga trajneri Mark Hjus, i cili gjatë një interviste për mediat angleze konfirmoi se futbollisti nuk do të largohet nga skuadra gjatë merkatos së janarit. Numri një i stolit deklaroi se 26-vjeçari është shumë i rëndësishëm për lojën dhe vazhdimësinë e skuadrës. Xherdan Shaqiri është pjesë e klubit anglez që nga korriku i vitit 2015 kur u transferua nga Interi për shumën e 14.5 milionë eurove.



KARATE, EDICIONI I 18-TË I KAMPIONATIT MBARËKOMBËTAR

Në këtë Kampionat morën pjesë sportistë nga mbarë trojet shqiptare, siç janë Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, derisa shqiptarët e Maqedonisë u përfaqësuan nga Unioni i Karatesë Shqiptare në Maqedoni

Shkup, 29 nëntor - Me rastin e festës së Flamurit, nën patronazhin e Federatës së Karatesë të Kosovës, në Prishtinë është mbajtur edicioni i XVIII-të i Kampionatit Mbarëkombëtar në Karate. Në

UKSHM fiton 11 medalje



këtë Kampionat morën pjesë sportistë nga mbarë trojet shqiptare, siç janë Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, derisa shqiptarët e Maqedonisë u përfaqësuan nga Unioni i Karatesë

Shqiptare në Maqedoni. Ata në këtë eveniment bënë një paraqitje të shkëlqyer duke u stolitur me 11 medalje, nga të cilat 6 të argjendta dhe 5 të bronzta. Ndryshe, me medalje të argjendte u stolisën

Flamur Mustafi (kata-senior), Blerita Beqiri (seniore -68 kg), Omer Musliu (kadete -63 kg), Loriana Ramo (kadete -48 kg), Nijazi Hamidi (junior -55kg) dhe Ilira Xheladini (juniore -48 kg), ndërsa me

medalje të bronzte u stolisën Shujb Ramadani (kadete -52 kg), Adis Neziri (kadete -70 kg), Rudina Capo (juniore -53kg), Medin Dema (kadete -kata) dhe Muhamed Dovolani (junior -76 kg). Ndërkohë, në këtë Kampionat drejtësinë ndanë edhe Gjyqtarët në kuadër të UKSHM, Nuredin Misini (gjyqtar botëror), Samir Saliu dhe Argjend Musliu. Kurse, trajnerët të cilët udhëhoqën sportistët tanë ishin Irfan Aliu (K.K “Kushtrimi”), Seful Osmani (K.K “Rinia”), Shaban Murtishi (K.K “Drini”) sportistë në kuadër të UKSHM ishin edhe nga K.K “Uraniku” dhe K.K “Bashkimi 2002”. Në fund, kryetari i UKSHM-së Alim Hajredini, kërkoi që edicioni i ardhshëm i këtij manifestimi t’u besohet shqiptarëve të Maqedonisë.

FLOJD MEJVEDER GATI PËR RIKTHIMIN E DYTË

SYNON SËRISH SFIDËN NDAJ MEKGREGOR

Kohët e fundit Mejveder ka nisur të stërvitet sërish dhe janë të shumtë ata që mendojnë se dy kampionët mund të ngjiten përsëri në ring, në një revansh. Mejveder ka vendosur më 26 gusht rekordën e 50 fitoreve dhe asnjë humbje si profesionist, por mbi të gjitha arkëtoi mbi 300 milionë dollarë, kundrejt 100 milionëve të rivalit irlandez të arteve marcialë mikse

Duket se Flojd Mejveder nuk qëndron dot për një kohë të gjatë jashtë ringut dhe po mendon të rikthehet sërish aktiv, në një tjetër sfidë boksi. Kampioni amerikan i peshës "welter", pas tërheqjes dy vite më parë, u rikthyer në ring këtë vit, ku korri fitoren e 50-të në karrierë, pas triumfit me "KO teknik" ndaj Konor MekGregor. Kjo ishte një sfidë e madhe, që bëri shumë bujë dhe mbushi plot xhepat e dy sportistëve, që duket se

janë gati të dhurojnë një përballje të dytë. Kohët e fundit Mejveder ka nisur të stërvitet sërish dhe janë të shumtë ata që mendojnë se dy kampionët mund të ngjiten përsëri në ring, në një revansh. Mejveder ka vendosur më 26 gusht rekordën e 50 fitoreve dhe asnjë humbje si profesionist, por mbi të gjitha arkëtoi mbi 300 milionë dollarë, kundrejt 100 milionëve të rivalit irlandez të arteve marcialë mikse. Dje, televizioni i



njohur i amerikan "TMZ" ka deklaruar se Mejveder mund të zhvillojë edhe një përballje të fundit në ring, para se të varë për herë të fundit "dorzat në gozhdë". Burime pranë "TMZ" bëjnë me dije se boksi amerikan po stërvitet fuqishëm në pale-

stër për këtë revansh me MekGregor, pasi e di që nuk do ta ketë të lehtë të korrë një tjetër fitore ndaj irlandezit. Për momentin nuk ka asnjë njoftim zyrtar, por ky revansh do të ishte një tjetër përballje e madhe e boksit mes dy kampionëve.



Burime pranë "TMZ" bëjnë me dije se boksi amerikan po stërvitet fuqishëm në palestër për këtë revansh me MekGregor, pasi e di që nuk do ta ketë të lehtë të korrë një tjetër fitore ndaj irlandezit.

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor

MKD
СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

SHPLLJA E AKTVENDIMIT

Në bazë të nenit 87 paragrafi 1 dhe nenit 90 paragrafi 1 pikës 5 të Ligjit të Mjedisit Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 42/2014 dhe 44/2015), Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor më 21.11.2017 soll

AKTVENDIM

- Ky Aktvendim jep Pëlqimin për kërkesën për zbatimin e projektit: "Ngritja e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Lindjes dhe Verilindjes", për nevojat e investuesit Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.
- Studimi i Vlerësimit të Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor i projektit "Ngritja e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Lindjes dhe Verilindjes" i plotëson kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor duke zbatuar masat për parandalimin dhe reduktimin e efekteve të dëmshme në mjedisin jetësor, me humarje ndaj investitorit për ta zbatuar në mënyrë të qartë planin e menaxhimit të mjedisit jetësor dhe programin e monitorimit.
- Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon investuesit, gjatë ndërtimit të Centrali Qendror për menaxhimin e mbeturinave me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësore, për të mbrojtur të gjithë zonën e njëjtë. Mbrojtja duhet të bëhet me: vendosjen e argjilës ose argjilës artificiale të bazuar në natrium; instalimin gjeomembranë dhe instalimin e gjeotekstilit.
- Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe do të publikohet brenda pesë ditëve të punës nga dita e miratimit të tij të paktën në një gazetë ditore të disponueshme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë në faqen e internetit dhe në tabelën e shpalljeve në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, investuesi, personat e tanguar juridikë ose fizikë, si dhe shoqatë e qytetarëve të formuara për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor, mund të paraqesin ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënieve të Punës në shkallë të dytë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të fundit të vendimit në pajtim me nenin 90 paragrafin (1) pikën 5 të Ligjit të Mjedisit Jetësor.

Aktvendimin e plotë për dhënien e pëlqimit të Studimit të Vlerësimit të Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor për projektin: "Krijimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Lindjes dhe Verilindjes" mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor - www.moiepp.gov.mk

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit
Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor

Bul. "Goce Dellçev" nr.18,
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
Tel. (02) 3251 400
Faks. (02) 3220 165
E-posta:
info@moiepp.gov.mk
Ueb faqja: www.moiepp.gov.mk

Shkolla e mesme komunale
Gjimnazi "Mirçe Acev" – Prilep
Rr. "Prilepski Braniteli" nr. 96a
Tel/faks: 048/425-841
www.gimprilep.edu.mk

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës nga shkollat e mesme ndërsa në pajtim me nenin 24 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit për arsim të mesëm, Kryetari i komisionit për grumbullimin e ofertave publikon

SHPLLJE

Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve përfundimtare

Shkolla e mesme komunale Gjimnazi "Mirçe Acev" – Prilep në pajtim me Programin për realizim të ekskursionit përfundimtar (shumëditor) për nxënës të vitit të tretë, në vitin shkollor 2017/2018 dhe mendimet të marrë nga Këshilli i Prindërve dhe Broyja për zhvillim në arsim, organizon:

Ekskursion shumëditor përfundimtar me nxënës të vitit të tretë jashtë Republikës së Maqedonisë (Prilep – Serbi – Kroaci – Shpella e Postojnës – Venedik – Veronë – Pizë – Firence – Romë – Napoli – Bari ose Brindizi – Igumenicë ose Durrës – Prilep.

Vendet të cilat duhet të vizitohen me biletalet e përfshira në çmim:

- Vizitë të Shpellës së Postojnës – Slloveni
- Shëtitje nëpër qytetin e Venedikut me guidë lokale: Kisha San Marco, Palazzo Ducale, Ponte dei Sospiri, ura Rialto dhe Kanali Grande
- Shëtitje nëpër qytetin e Veronës: sheshet, Arenën dhe Shtëpinë e Xhulietës
- Shëtitje nëpër qytetin e Pizës: sheshi Duomo me Kullën e pjerrtë
- Shëtitje nëpër qytetin e Firences me guidë lokale: katedra Santa Maria del Fjore, pallati Vekio – Kuvendi i qytetit, sheshi Sinjoria, statujtë e Davidit të Mikelanxhelos, urën e vjetër Ponte Vekio
- Vizitë të Vatikanit me guidë lokale: Muzeutë e Vatikanit, kishën e Shën Pjetrit, Kapela Sistina
- Shëtitje nëpër qytetin e Romës me guidë lokale: Forumi romak, Koloseumi, Forumi i mbretit Trajan, Kapitoli, sheshet Venecia dhe Espania, Fontana di Trevi, sheshi spanjoll, vizitë të kishës së Shën Klimentit
- Vizitë të qytetit të Napoli: Pallati mbretëror, kisha San Francesco di Paola, kështjella Kastel Nuovo

Në kërkesën e ofertave mund të paraqiten subjekte juridike të cilat i plotësojnë kriteret në vijim:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për realizim të aktivitetit turistik përkatës
- të ketë të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 (tre) ekskursione për nxënës gjatë 3 (tre) viteve të fundit
- të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për sigurim në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve

Në kushtet e dhëna në ofertë nuk duhet të ketë zgjidhje alternative gjegjësisht të njëjtat janë përcaktuar saktë pa mundësi për t'u ndryshuar. Në ofertë duhet të jenë të përfshira shpenzimet e rrugës, ushqimi me meny (menües dhe darkë) akomodim në hotele me së paku tre vje, sigurim themelor ose standard rrugor pa franchizë, të sigurohen guidë dhe mjekë (së paku dy mjekë) për udhëtimin. Agjencia është e obliguar që të paraqesin në ofertë çmimet sipas pozitive, gjegjësisht çmimet të veçanta për çdo butijë (me darkë dhe drekë), çmim të veçantë për biletalet, çmim të veçantë për guidë lokale. Çmimet e posaçme së bashku me shpenzimet për rrugë dhe sigurim rrugor të ofrojnë shumën e çmimit të ekskursionit për nxënës.

Pagesa të bëhet në gjashtë këste të barabarta mujore (janar-qershor 2018), ndërsa ekskursioni të realizohet në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) ditë në muajin prill të vitit 2018, me 3 (tre) butijë, edhe atë një butijë në Lido di Jesolo dhe dy butijë në Romë.

Agjencia në ofertë të ofrojë edhe kushte të volitshme për nxënës që vijnë nga familjet e prekura sociale edhe atë 5% të numrit të përgjithshëm të nxënësve që do të shkojnë në ekskursionin përfundimtar.

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofruesi i zgjedhur është i obliguar që të dorëzojë garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 15% nga vlera e përgjithshme marrëveshjes.

Kriteri për zgjedhje është çmimi më i ulët gjatë kushteve të njëjta nga ofruesit.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë.

Informacionet e nevojshme shtesë në lidhje me ekskursionin, agjencia mund t'i marrë në kontakt të drejtpërdrejtë me shkollën ose përmes formës elektronike në e-mail adresën: gimnapp@yahoo.com. Personi për kontakt: u. D. Drejtori Dimçe Nastoski dhe udhëheqësi i ekskursionit Anika Stvanoska Jançeska.

Ofertat të dorëzohen në adresën: Shkolla e mesme komunale – Gjimnazi "Mirçe Acev", rr. "Prilepski Braniteli" nr. 96a, Prilep, në zarf të mbylltur me shenjë "Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursione përfundimtare".

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Komisioni për grumbullimin e ofertave
Gordana Risteska Tunaska

Në bazë të nenit 39 të Ligjit për standardet e studentëve dhe nenit 41 të Statutit të Konviktit shtetëror për studentë "Shkup" – Shkup, Këshilli drejtues i:

**KONVIKTIT SHTETËROR PËR STUDENTË
"SHKUP" – SHKUP**
Publikon
SHPLLJE PUBLIKE
për zgjedhje të drejtorit

Në pajtim me nenin 39 të Ligjit për standardin e studentëve, Këshilli drejtues i Konviktit ka sjellë vendim për publikim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit, në bazë të së cilit publikohet shpallje për zgjedhje të drejtorit të Konviktit shtetëror për studentë "Shkup" – Shkup.

Krahas kushteve të përgjithshme me Ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- Në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të kenë të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 të arsimit;
- Të posedojnë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS – së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
- FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
- BULATS – së paku 60 pikë

- Të ketë të dhënë testin psikologjik ose testin për integritet.
Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkurs duhet të paraqesin dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje për konkurs;
- certifikatë të shtetësisë;
- vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- diplomë origjinale – certifikatë për arsim sipëror të mbaruar ose kopje të vërtetuar në noter;
- vërtetim për përvojën e punës;
- certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze;
- dëshmi për test të dhënë psikologjik ose test për integritet;

Fletëparaqitjet për shpalljen me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në arkivin e Konviktit ose në adresën në vijim: Konvikt shtetëror për studentë "Shkup" – Shkup, rr. "Metropolit Teodosija Golloganov" nr. 26-b, Shkup.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afatet në pajtim me Ligjin për standard të studentëve.

KËSHILLI DREJTUES
I KONVIKTIT SHTETËROR PËR STUDENTË "SHKUP" – SHKUP

Në bazë të nenit 126 alineja 7 të Ligjit për shkolla fillore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08) dhe plotësimin ligjin deri më 2015) neni 71 alineja 7 e Statutit të shkollës fillore komunale "Liman Kaba" Luboten – Butel dhe Vendimit nr. 09-962/2 i datës 21.11.2017 të Kryetarit të Komunës Butel, Këshilli i shkollës fillore shpall:

KONKURS
Për zgjedhje të drejtorit të shkollës.

Kushtet:

1. Për drejtor të shkollës kanë të drejt të konkurrojnë të gjithë personat të cilët kanë të kryer arsimin sipëror dhe që i plotësojnë kushtet për arsimtar ose bashkëpunëtor profesional të kenë 5 (pesë) vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimor dhe të kenë të dhënë provimin për drejtor.
2. Në rast se në konkurs nuk paraqiten kandidatet me provim të dhënë do të zgjidhet kandidati, por me kusht që në afat prej një viti të jep provimin.
3. Konkursi është i hapur 5 ditë pune nga dita e shpalljes.
4. Dokumentet e pa kompletuara dhe të vonuara nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i këshillit të shkollës.

Shitet toke në Shkup, gjendet në Koliqan të Epërm;
PK 2736, vendi i quajtur Novosir, me sipërfaqe prej 1642m², e regjistruar ne Flet pronësi nr. 83 për KK Koliqan i Eperm pronësi e Garip Osmani. Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelat në fjalë, ofertat e tyre mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Mahir Ziberit, rr. Butelska nr. 4, Shkup-Butel.

URGJENTISHT
Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

DY TRANSPLANTE MËLÇIE KRIJUAN "ARMËN SEKRETE" TË REAL MADRIDIT

HISTORIA E PABESUESHME E

TERRY NELSON



Nelson, 55 vjeç, për Real Madridin njihet si krijuesi dhe dizajneri i asaj që ish-trajneri Hoze Murinjo e quante "armën sekrete" të klubit, një kostum special që përdoret për të ndihmuar lojtarët e dëmtuar të stërviten në ujë, duke i mundësuar të ruajnë formën fizike kur ata nuk janë në gjendje të vrapojnë normalisht

Sa herë që një nga yjet e Real Madridit dëmtohet, një nga njerëzit e parë që kontakton stafi i doktorëve të klubit është Terry Nelson. Nelson është shumë gjëra, shpikës dhe sipërmarrës, atlet special, por ai nuk është doktor apo kirurg. Gjithsesi, fizioterapistët e Real Madridit mundohen ta kontaktojnë menjëherë pasi është dëmtuar një lojtar. Shpeshherë për ta informuar mbi gjendjen e lojtarit. Ndonjëherë për të kërkuar një këshillë. Diçka e pabesueshme, ashtu siç është edhe historia e këtij njeriu.

Nelson, 55 vjeç, për Real Madrid njihet si krijuesi dhe dizajneri i asaj që ish-trajneri Hoze Murinjo e quante "armën sekrete" të klubit, një kostum special që përdoret për të ndihmuar lojtarët e dëmtuar të stërviten në ujë, duke i mundësuar të ruajnë formën fizike kur ata nuk janë në gjendje të vrapojnë normalisht. Kostumi i parë i shitur drejt klubit në 2012 përbëhej nga një material sintetik që quhet "Lycra", najlon dhe shkurë. Pas një demonstrimi në qendrën stërvitore të klubit në Valdebebas, departamenti mjekësor i Real Madridit porositi menjëherë 50 copë. Ato tani formojnë një pjesë bërthamore të punës rikuperuese të lojtarëve të Real Madridit. "Ata i përdorin katër apo pesë herë në javë, me grupe të vogla lojtarësh," shprehet Nelson. Kostumi, siç shpjegon Nelson, tregon historinë e jetës së tij.

Pas karrierës së tij të shkurtër e cila përfundoi në fillim të viteve 1980


ku u la i lirë nga academia e Liverpool, ai u stërvit t'i bashkohej Regjimentit të Parashutistëve të Britanisë. "Stërvitja më e rëndë në botë," rikujton ai. Por testi i bërë në ushtri zbuloi një problem në gjak që eventualisht çoi në probleme të mëdha me mëlçinë. Nelsonit iu tha se kishte vetëm 6 muaj për të jetuar. Vëllai i tij, Dean, dhuroi një mëlçi për ta mbajtur gjallë. Nelson, i vendosur të paguajë zemërgjerësinë e vëllait, vendosi të konkurronte në "World Transplant Game" në Vancouver të Kanadasë. "Dy javë përpara se të shkoja, theva



Pas karrierës së tij të shkurtër e cila përfundoi në fillim të viteve 1980 ku u la i lirë nga academia e Liverpool, ai u stërvit t'i bashkohej Regjimentit të Parashutistëve të Britanisë. "Stërvitja më e rëndë në botë," rikujton ai. Por testi i bërë në ushtri zbuloi një problem në gjak që eventualisht çoi në probleme të mëdha me mëlçinë

kockën e gishtit të madh të këmbës, dhe doktorët më thanë se nuk do të rikuperohesha në kohë". Por ai nuk donte të dorëzohej, dhe filloi të përdorte breza të lundrueshëm duke u stërvitur në një pishinë. Dëmtimi iu shërua. Ai vrapoi, dhe fitoi medaljen e floririt. Por, trupi i tij filloi të mos pranonte mëlçinë e re. Mushkëria iu mbush me lëng. Për 12 vite ai iu nënshtrua dializës. Iu tha të mos bënte ushtrime, por ai e injoroi atë këshillë. "Vrapo 20 minuta në pishinë më ndihmonte shumë, më bënte të ndihesha shumë pozitiv", pohon Nelson. Pas një transplantit të dytë, nga partnerja e vëllait të tij, gjendja e tij u përmirësua. Dhe si rezultat ai u fokusua te puna në pishinë duke krijuar kompaninë "Aqua Running". Disa vite më parë ia humbi pjesën e poshtme të këmbës së tij të djathtë si pasojë e problemeve të mëdha me mëlçinë. Ai u rikthye në ujë, duke vrapuar, 10 ditë më pas.

Shumë njerëz të botës së futbollit dëgjuan për shpikjen e tij. Lista e klientëve të tij përbëhet nga emra si Kristiano Ronaldo, Geret Bejll dhe pjesa tjetër e yjeve të Real Madridit kanë veshur kostumet e tij, Diego Maradona i provoi kur ishte trajneri i AL Vasl në Dubai, duke blerë kostumin jo vetëm për veten e tij por edhe për familjarët e tij, ku përfshihet edhe Sergjio Aguero. Tashmë Nelson punon me mbi 12 klube të Premier Ligës ku përfshihen Mançester Junajtedi, Totenhami dhe Liverpooli.



Kostumi i parë i shitur drejt klubit në 2012 përbëhej nga një material sintetik që quhet "Lycra", najlon dhe shkurë. Pas një demonstrimi në qendrën stërvitore të klubit në Valdebebas, departamenti mjekësor i Real Madridit porositi menjëherë 50 copë. Ato tani formojnë një pjesë bërthamore të punës rikuperuese të lojtarëve të Real Madridit

AUTOBIOGRAFIA E GRIZMANN ZBULON TË GJITHA SEKRETET

MUND TË VESH FANELLËN E MANÇESTERIT

“Mançesteri është një mundësi. Edhe pse e dua shumë Pogban, kjo nuk do të ndikojë në vendimin tim. E ardhmja? Unë nuk e di nëse do ta vesh ndonjëherë fanellën e Mançesterit”, – thotë në një tjetër kapitull

Autobiografia e Grizmann zbulon të gjitha sekretet, me të cilat sulmuesi francez ka kaluar në botën e futbollit. Edhe një herë, ai nuk e përjashton mundësinë e veshjes së fanellës së Mançester Junajtedit. “Nuk kam asgjë kundër Anglisë, përveç motit”, – thotë ai me shaka. “Mançesteri është një mundësi. Edhe pse e dua shumë Pogban, kjo nuk do të ndikojë në vendimin tim. E ardhmja? Unë nuk e di nëse do ta vesh ndonjëherë fanellën e Mançesterit”, – thotë në një tjetër kapitull, i cili flet për të gjithë lojtarët e mëdhenj, të cilët kanë veshur fanellën me numrin 7 në klubin anglez, me kalimin e viteve. “Unë e kam përdorur gjithmonë këtë numër, sepse Dejvid Bekam ishte modeli i rolit absolut”, shtoi më tej Grizmann. Sulmuesi

francez e hapi këtë verë mundësinë e bashkimit me klubin anglez. Më tej, Grizmann tregon skuadrën që refuzoi. “Kisha një propozim nga trajneri i Barcelonës në atë kohë, Pep Guardiola, në vitin 2011. Zgjodha Atletiko Madridin para Totenhemit në vitin 2014 dhe hodha poshtë ofertën e PSZH-së në vitin 2015”, shkruan francezi. Sulmuesi francez bën me dije se ishte një hap larg nga Arsenalit. “Skauti i Arsenalit, Gilles Grimandi, më tha verën e vitit 2013 se Venger ishte i interesuar, kështu që duhet të lija mënjatë të gjitha ofertat e tjera. Prita e prita, mbeta në pritje, por nuk kishte asnjë lajm. Së fundi, disa orë para se të mbyllej merkatoja, Grimandi më tha se Arsenali nuk do të bëjë ndonjë lëvizje”. Po cili është vendi ku ai dë-

shiron ta përfundojë karrierën? Francezi përgjigjet: “Do të doja ta përfundoja në ekskluzivitetin e propozuar nga Beckham për MLS në Majami”, përfundoi Grizmann.



Kisha një propozim nga trajneri i Barcelonës në atë kohë, Pep Guardiola, në vitin 2011. Zgjodha Atletiko Madridin para Totenhemit në vitin 2014 dhe hodha poshtë ofertën e PSZH-së në vitin 2015. Pastaj, skauti i Arsenalit, Gilles Grimandi, më tha verën e vitit 2013 se Venger ishte i interesuar, kështu që duhet të lija mënjatë të gjitha ofertat e tjera. Prita e prita, mbeta në pritje, por nuk kishte asnjë lajm. Së fundi, disa orë para se të mbyllej merkatoja, Grimandi më tha se Arsenali nuk do të bëjë ndonjë lëvizje



Publicitet

Te Barça të gjithë e duan Kutinjon

Vendimmarrësit e Barcelonës janë të bashkuar në besimin e tyre, se lojtari i Liverpoolit, Filipe Kutinjo, është ylli i vetëm, me të cilin duan të nënshkruajnë në janar”, – thotë gazeta katalanase. Në “Camp Nou” e kanë të qartë se përmirësimi i cilësisë së skuadrës aktuale vjen me lojtarët që bëjnë ndryshimin. Kjo është diagnoza e Blaugranave për një sezon, në të cilin të gjithë kanë vënë gjoksin për të rimarrë konkurrencën dhe esencat kolektive të lojës. Në këtë pikë ka njëzëshmëri në bordin drejtues të Barcelonës. Në këtë skenar konsiderohet se, në merkaton e dimrit, sekretariati teknik duhet të afrojnë emra që bëjnë ndryshi-

min, për të frikësuar rivalët. Vetëm një prej tyre nxiti unanimitet, Kutinjo. Barça u përpoq deri në minutën e fundit në merkaton e verës. Braziliani nuk ka hequr dorë dhe në muajt e fundit ka lëvizur me efikasitet prapa skenave për të lehtësuar largimin e tij të menjëhershëm nga “Anfield Road”. Kutinjo do të mbërrinte në “Camp Nou” për t'u rritur si futbollist, për të arritur zenitin e tij dhe për të respektuar rrogat dhe hierarkitë e futbollit, që mbizotërojnë në klubin katalanas. Brenda fushës, ai do të sillte çekuilibër në anën e majtë dhe mund të marrë pozicionin natyror të Neymar.



Do të jem i lumtur kur Silva do të rinovojë



Pep Guardiola ka një shqetësim kohët e fundit: rinovimi i David Silva. Aq shumë e mundon kjo gjë, sa trajneri i Mançester Siti vendosi ta shprehte publikisht para mediave. “Kur të kemi nënshkruar kontratën me të, atëherë do të jemi të lumtur. Ajo që ai ka bërë për këtë klub do të jetë e

shkruar në librat e historisë. Unë shpresoj që të vazhdojë. Në të ardhmen, ndoshta nuk mund të luajë çdo tre ditë, por klubi ka nevojë për lojtarë që kanë luajtur këtu gjatë. Silva është një legjendë e vërtetë”, u shpreh Pep. Përveç kësaj, në kohët e fundit është folur mbi disa skuadra të interesuara për mesfushorin spanjoll. Milani dhe Las Palmas janë duke parë se çfarë ndodh me Silva dhe Mançester Siti. Silva, i cila mbush në janar 32 vjeç, ka një kontratë me “qytetarët” deri në vitin 2019. Klubi do ta zgjasë atë marrëveshje edhe për një vit, çka rumbullakos dhjetë vite të tij në ekipin anglez. Përflitet se mesfushori spanjoll është pranë nënshkrimit të një kontratë të re deri në vitin 2020 dhe me një pagë prej 167.000 euro në javë.

libri i artë

2017/18

udhërrëfyes mjekësi
FAQ. 133

udhërrëfyes mobilie/ndërtimtari
FAQ. 153

KOPJE FALAS me gazetën Koha më 2 Dhjetor (e shtunë)

ZBRITJE DHE GRATISE
24 KUPONË PREMIUM



ELON MUSK KRIJON BATERINË MË TË MADHE NË BOTË

Bateritë me litium-jon fuqizojnë telefonin, laptopin dhe kamerën tuaj. Por lajmi tani është se Elon Musk do të furnizojë me energji Australinë e Jugut. CEO i Tesla zbuloi të enjten se kompania e tij sapo ka përbushur premtimin për të ndërtuar dhe instaluar baterinë më të madhe të litiumit në botë brenda 100 ditësh. Në një bast të bërë në Twitter,

Musk tha se nëse kompania e tij nuk arrihet të përbushë afatin e fundit për të ndërtuar sistemin e Powerpack, ai do të pësonte projekt-ligjin e përafërt prej 50 milionë dollarë dhe qeveria e Australisë së Jugut mund ta kishte atë pa pagesë. Tesla e kaloi linjën me rreth një javë për të kursyer. E projektuar për të ruajtur energjinë e ripërtërishme, bateria e Tesla

ka 100 megavat kapacitet. Pas testimit të plotë, sistemi do të çiftëzohet me fermën e erës Hornsdale 120 milje në veri të Adelaide, të operuar nga ofruesi i energjisë së ripërtërishme franceze Neoen. Mega-bateria do të ruajë energjinë e tepërt të krijuar nga turbinat me erë dhe të përdoret si dhe kur kërkohet.



BIRRE PËR QENTË

Tani edhe qentë do të kenë birrën e tyre. Browser Beer është pija e parë për kafshët, e cila ka fituar dhe çmimin si birra më e mirë nga World Records Academy. Ndryshe nga birrat që njerëzit pinë, kjo nuk ka alkool. Është e krijuar vetëm nga elbi e nëse keni dëshirë dhe ju mund ta provoni, nuk është aspak e dëmshme. Ideja për këtë produkt ishte e Jenny Brown dhe po përdoret në 40 shtete të Amerikës. Disa qen preferojnë ta pinë direkt nga shishet e disa në ushqimin e tyre.

KINEZËVE U OFROHEN KURSE PËR RËNIEN NË DASHURI



Zhang Zhenxiao i ka 27 vjet. Ai nuk ka qenë kurrë në lidhje. Tani ai thotë se është i gatshëm për dashuri, por si shumë burra të tjerë në Kinë, ai nuk e di se si t'ia fillojë. Prandaj Zhang ka vendosur që të shkojë në kurs. Shkolla për "Vetëdijimin emocional të rënies në dashuri" e ka mësuar atë se si të kujdeset për veten, si t'i qaset një gruaje dhe t'i lërë asaj përshtypje. "Ka shumë njerëz të cilëve u mungon aftësia për të pasur lidhje", thotë Zhang, që në tetor ishte regjistruar në kursin treditësh, shkruan "The New York Times", transmeton Koha Ditore.

"Shumë herë nuk është se diçka nuk është në rregull me ne. Thjesht, ne nuk i dimë detajet, të cilave duhet t'ua vëmë veshin". Derisa takimet e dashurisë janë të komplikuar kudo në botë, shumë më keq është për burrat kinezë në kërkim të një gruaje. Kina vetëm tani i ka dhënë fund politikës së një fëmije për familje, derisa një politikë e tillë në shtetin me preferencë të theksuar kulturore për djemtë kishte nxitur shumë çifte që të abortonin fetuset vajza. Më 2016 kishte rreth 33.6 milionë djem me shumë se vajza në Kinë, sipas Qeverisë.

EDHE NJË GRUAJA E DËSHPËRUAR NGA GJOKSI I STËRMADH: DUA TË ZVOGËLOJ NUMRIN

Danielle Matier, nëna 31-vjeçare ka një problem të madh. Gjoksi i madh e ka penguar atë që të ushqejë me qumësht djalin e saj Jack, pasi ajo kishte frikë se mos e mbyste. Gruaja e vuan këtë problem që në adoleshencë, ku gjoksi nuk ndalet së rrituri. Ajo ka vendosur që të kërkojë ndihmë për të zvogëluar gjoksin sepse situata është bërë e padurueshme. Nëna nga Britania e Madhe do që të operohet në Poloni pasi aty operacioni kushtin 4 mijë euro, ndërsa në Angli 7 mijë euro. Danielle lufton kundër gjoksit të saj që në moshën 11-vjeçare. "Që prej asaj kohe, -thotë-, nuk ka ndaluar së rrituri. Kam dhimbje të forta shpine për shkak të peshës së tyre. Por kur lindi djali im Jack, sot 6 vjeç, problemi është bërë edhe më urgjent. Mu




desh që të blija një biberon, sepse kisha frikë se mos e mbysja. Edhe me vajzën kisha të njëjtin problem. Sot Danielle ndihet e lodhur nga gjoksit i saj i stërmadh dhe kërkon ndihmë financiare për tu operuar. "E di që është më mirë që të operohem në



Angli-, pohon ajo, -por jam aq e dëshpëruar se do të shkoj në çdo ven për të zvogëluar numrin".


1648 - Ushtria angleze zë rob Mbretin Charlsin I.
1678 - Roman katolikët ndalohen nga Parlamenti anglez.
1700 - Turqia i shpall luftë Rusisë.
1731 - Tërmeti godet Pekinin, rreth 100,000 të vdekur.
1735 - Shteti i Holandës ndalon Frankmasonerinë.
1782 - Britania nënshkruan marrëveshje për të njohur pavarësinë e SHBA.
1838 - Meksikoja i shpall luftë Francës.
1950 - Presidenti amerikan Truman kërcënon Kinën me bombë atomike.
1957 - Tentim vrasje ndaj kryetarit të Indonezisë Sukarno.
1966 - Barbados fiton pavarësinë nga Britania.
1990 - Bushi propozon takim mes SHBA dhe Irakut për të mënjanuar luftën.

Uji i rubinitit në Kanada, vlerësohet se është i një standard më të lartë shëndetësor se sa uji që tregtohet në shishe.



Në det ekziston një peshk me mish blu i quajtur "Blue Lingcod". Arsyeja e ngjyrës së tij të pazakontë, mbetet ende një mister për biologët.

Zogjtë e vegjël që zukasin si Kolibri, kanë një metabolismëm kaq të lartë sa që janë gjithnjë 4 orë larg nga ngordhja prej urisë.



KUJDES SHKALLËN

Gjatë funeralit të një muratori, një burrë i panjohur për familjen, po qante me të madhe. Gruaja e të ndjerit i afrohet dhe e pyet:
- Ishit shok i tij?
- Po!
- Kaq shumë e donit?
- Shumë, madje fjalët e fundit mi dedikoi mua...
_ E çfarë ju tha?
- Kujtimito, mos e lëviz shkallën!



Kur një njeri dëshiron shumë gjëra, nuk ka vetveten...
(Konfuci)